



FORUM

**Ikja**



Kjo është pamja sot. Ata që duhet të punojnë për të ardhmen e fre-nojnë atë. Ata që duhet të punojnë për njerëzit i shfrytëzojnë ata. Ata që duhet të japin shpresë e vdesin atë. Dhe për fat të keq në kulmin e krizës politike, e vetmja zgjidhje i bie të jetë ikja. Prandaj dhe jo rastësisht dominon si opsion. E kur të gjithë të kenë ikur, s'do ketë më rëndësi asgjë. As marrëveshja, as e emri i shtetit e as ata pak që do kenë mbetur. Skandali do jetë, se ata që do jenë, apo dhe që janë faktorë për ikjet në fakt... Fq.10

RAJON

**INTERPOL-i dhe FSK-ja, dy betejat diplomatike të Kosovës me Serbinë**

Fq.14

SPECIALE

**Lirohet ndihmësi i atentatorëve të 9/11**

Fq.12



**MBI DY MIJË FOSH NJE ÇDO VIT**

# “BABY BOOM” ME TË TRETIN, SHQIPTARËT TË PARËT



Zonat me boom-in më të madh sa i takon lindjes së fëmijës së tretë është Shkupi (9562 fëmijë) dhe Pollogu (4291 fëmijë). Dallimi me vitin paraardhës është i madh, sidomos për rajonin e Shkupit ku numri i fëmijëve është më i madh se 1100. Por pavarësisht rritjes së numrit të familjeve që vendosin të kenë “fëmijën e tretë”, numri i lindjeve të fëmijës së parë apo të dytë vjen gjithnjë duke u reduktuar, e për rrjedhojë, edhe rritja natyrale e popullsisë ecën me ritëm të ngadaltë

Fq.4

## Varfëria, një e pesta e popullatës në rrezik

Shkup, 17 tetor - Reformat që bëhen në sferën sociale për zvogëlimin e dhe çrrënjosjen e varfërisë duhet të jenë rrënjësore dhe të qëndrueshme, të bëra konform kërkesave dhe nevojave të të varfërve dhe personave në rrezik nga varfëria. Ata duhet të marrin më shumë mjete për ndihmë dhe mbështetje, por edhe të integrohen në shoqëri dhe në tregun e punës. Vetëm kështu do të mundësohet që ata të da-

lin nga gjendja në të cilën ndodhen. Këto janë një pjesë e qëndrimeve të pjesëmarrësve në Konferencën për të varfëritë dhe persona të përjashtuar nga shoqëria, që po mbahet me rastin e Ditës ndërkombëtare për çrrënjosje të varfërisë. “Ne kemi qenë dëshmitarë se 11 vite varfëria dhe personat e shkyçur nga shoqëria janë keqpërdorur për shkaqe të ndryshme dhe se nuk janë miratuar politika... Fq.7





## EDITORIAL

# EDHE ZHVILLIMI RURAL, NË NDRYSHIMET E ARDHSHE KUSHTETUESE



Emin AZEMI

Partitë politike, ngjashëm si disa shkencëtarë të mjekësisë, vazhdojnë ta trajtojnë zhvillimin rural si "zorë qorre". Disa shkencëtarë besojnë që dinë përse shërben zorra qorre, ndërkaq disa të tjerë mendojnë që ajo nuk ka kurrfarë funksioni.

Në Programin për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural në vitin 2018, ofrohen më shumë investime në tri masa kryesore, siç janë: "Përmirësimi i cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale", "Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave", si dhe "Ruajtja dhe avancimi i vlerave tradicionale në viset rurale". Të gjithë këto masa janë të dedikuara për investime të ndryshme kapitale në infrastrukturën rurale, kurse vitin e kaluar mjetet për përmirësimin e rrugëve deri tek fushat, gjegjësisht tokat pjellore, i shfrytëzuan komunat Kratovë, Vevçan, Pllasnicë, Bosillovë, Zrnovci, Koçanë, Debarcë, Gradsko, Vasillevë dhe Gradsko.

Përmirësimi i cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale, do të ishte parakushti themelor që njerëzit të mos i braktisin vendlindjet, kurse Programi për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural, është menduar të jetë terapia më adekuate që këto vendbanime të fillojnë të mendojnë për gjetjen e resurseve që do t'iu sigurojnë mirëqenie dhe prosperitet.

Shqiptarët në Maqedoni në një përqindje të madhe jetojnë nëpër fshatra, por jo në Kratovë, Vevçan, Pllasnicë, Bosillovë, Zrnovci, Koçanë, Debarcë, Gradsko, Vasillevë dhe Gradsko. Financat shtetërore në vitin 2018 kanë shkuar atje ku shqipja trajtohet ende si gjuhë e dorës së dytë, e cila jo patjetër duhet të ketë status të barabartë zyrtar.

Në Pollog, Likovë, Haraçinë, Radushë, pastaj në fshatrat shqiptare të Pellagonisë etj. ende nuk ka mbërritur Programi për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural. Por, sa interesant, ka mbërritur në Vevçan. A ka nevojë ta dimë se pse?

Ata që nuk e dinë se pse rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave ka vetëm adresë maqedone, do të duhej ta shfletojnë Kushtetutën aktuale dhe të gjejnë zbrazëtira, të cilat duhet plotësuar me amendamente që projektojnë zhvillim të barabartë të rajoneve, ku financat shtetërore nuk do të shkonin vetëm në Kratovë, Vevçan, Pllasnicë, Bosillovë, Zrnovci, Koçanë, Debarcë, Gradsko, Vasillevë dhe Gradsko, por edhe në Zhelinë, Haraçinë, Bogovinë, Oslome, Dollogozhdë, Dibër, Likovë, Çegran, Llopat, Saraj etj.

Shteti i së ardhmes, që nesër do të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së nuk guxon të shkelë me opinga të baltosura nga fshatrat e vetmuara maqedonase, ku vetëm pleqtë e lënë pasdore bëhen sikur po e ndihmojnë zhvillimin rural, ndërkohë që të rinjtë shqiptarë në Maqedoninë Perëndimore dhe Veriperëndimore as që kanë dëgjuar për "Ruajtjen dhe avancimin e vlerave tradicionale në viset rurale". Në Maqedoninë Lindore pleqtë i ruajnë fshatrat e braktisur nga bijtë e tyre drejtorë e nëpunës në Shkup, ndërkohë që në Maqedoninë Perëndimore, shumica e të rinjve shqiptarë jetojnë me solidaritetin financiar të xhaxhallarëve e dajallarëve në kurbet.

Programi për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural, duhet të jetë gjithëpërfshirës, mirëpo kjo nuk mund të bëhet nëse në ndryshimet e ardhshme kushtetuese nuk përfshihen saktësisht edhe fshatrat shqiptare, të cilët aktualisht janë rekrutuesit më të mëdhenj të fuqisë punëtore, por edhe kandidatët më potencialë për t'u bërë kurbetçinj të ardhshëm, nëse Kushtetuta e re nuk krijon parakushte për në zhvillim proporcional të rajoneve.

## NË EMËR TË DEMISTIFIKIMIT NUK MUND TË ZHVLERËSIOHET SKENDERBEU

"Theksime nga biseda në T7 'Skënderbeu dhe politika shqiptare sot në raport me veprën e tij':  
- Skënderbeu nuk ka nevojë për ne, por ne kemi nevojë për të dhe veprën e tij, veçmas në rrethanat kur politika shqiptare në Tiranë dhe Prishtinë, gjatë këtyre 20 vjetëve, botën shqiptare po mundohet politikisht dhe shpirtërisht ta kthejë në drejtim të Linjes, andej prej nga Skënderbeu e nxori?  
- Pse historiografia shqiptare lejoi që në emër të demistifikimit, të sulmohet deri në zhvlerësim heroi kombëtar?  
- Pse Akademia e Shkencave të Kosovës, me pranimin e Shmitit anëtarë me korrespondencë, u kyç në këtë fushatë dhe pse politika e Kosovës heshti?  
- Fjalori Enciklopedik i Kosovës, me probleme të mëdha, që duhet analizuar veç e veç...", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, historiani Jusuf Buxhovi, si rezume e debatit më të gjerë që ai ka pasur në një televizion kosovar.



## ÇËSHTJA ÇAME DHE HISTORIANËT SHTETËRORË

"Përse historianët shtetëror të Tiranës nuk flasin asnjëherë thellë për Çështjen Çame? Shumica e historianëve tiranas merren me Skënderbeun, Venedikun, Osmanët, Partizanët, tema që tashmë janë të vërtetuara, të pastruara nga ana historike, por asnjëherë për Çështjen Çame, një çështje e freskët, aktuale dhe delikate. Përse???  
Ndërkohë që Konsullata shqiptare në Janinë drejtohet nga diplomatë me kombësi greke, Konsullata shqiptare në Selanik drejtohet nga diplomat me leje qëndrimi si grekofonë, në ambasadën shqiptare në Athinë punojnë disa diplomatë me kombësi greke, zv/ministrja e jashtme e Shqipërisë është greke. Pse këta do i mbrojnë të drejtat e shqiptarëve në Greqi? Kjo mos është shpifje Dhimitër Bushati?", ka shkruar një status në Facebook, historian, Arben Lalla.



## PSE VENDET RURALE MBETEN RURAL?

"Përse njerëzit rural dhe vendet rurale mbeten rural? Sepse në vete ndërtojnë ndjenjën e apsolutizmit dhe betonizohen në këtë ndjenjë. Ndjenja e tillë nuk i toleron me hy në gara, sepse për gara duhet përmbajtur rregullave për t'u bërë yje.  
E për tu bërë yll, duhesh të jetosh i robëruar në sistem, ku mbi kokë do të kesh trajnerin, drejtorin dhe detyrë zbatimin urdhrave.  
Rajonet apo njerëzit që nuk pranojnë kontroll mbi ta në kuadër të ndonjë sistemi, e kanë të pamundur urbanizimin, qoftë kulturorë, qoftë ekonomik, apo social e shoqëror. Edhe pse si rajone mund të jenë nëpër rrafshina shumë pjellore, apo mund të jenë individ me diploma tamam", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



## MEDIA Citate

### UNMIK-u TË TËRHIQET NGA KOSOVA

Ambasadorja e deritanishme e SHBA-së në OKB, Nikki Haley, ka kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, që të tërheq misionin e UNMIK-ut nga Kosova. Letra është dërguar më 9 tetor, në po të njëjtën ditë kur Haley kishte njoftuar tërheqjen e saj nga posti i Ambasadores në OKB, ndërsa në letër ajo ka vlerësuar përpjekjet e Guterresit për ruajtjen e paqes në botë. "Kur misionet paqësore të OKB-së bëjnë punë të mirë, vendet janë në gjendje t'i japin fund konfliktit, të krijojnë procese demokratike politike dhe t'i zhvillojnë kapacitetet e veta. Për vite me radhë, misioni i OKB-së në Kosovë [UNMIK] ka qenë shembull i asaj se si OKB-ja ka menaxhuar një konflikt kompleks", ka thënë Haley. Suksesi i Kosovës, vazhdon Ambasadorja në letrën e saj, "i shënuar me 10 vjet pavarësi këtë vit, duhet të jetë shkas për festë dhe simbol i kontributit të madh të OKB-së ndaj paqes dhe stabilitetit në rajon". "Fatkeqësisht, UNMIK-u mbetet i pandryshuar, pavarësisht progresit dhe deklaratave të vazhdueshme nga shumica e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit se UNMIK-u ka kohë që e ka përfunduar mandatin e tij", shkruan më tej në letrën e Haleyt. "Për këto arsye, kërkoj nga Sekretariati të ushtrojë autoritetin e tij dhe të iniciojë një rishikim strategjik të UNMIK-ut për të zhvilluar një strategji dalëse. Ndërmarrja e këtyre hapave do t'i jepte KS të OKB-së informacione për t'iu qasur dhe vlerësuar prezencën e OKB-së në Kosovë, siç bëjmë me të gjitha misionet tjera të OKB-së. Marrja e këtij hapi, po ashtu, do të avanconte normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë në ambicjet e tyre të përbashkëta për t'u integruar me fqinjët e tyre evropianë. Për më tepër, jam e bindur se një rishikim i tillë dhe një strategji dalëse do të ruajë integritetin e përpjekjeve tuaja të gjera paqeruajtëse për reforma", ka theksuar tashmë Ambasadorja në largim e SHBA-së në OKB, Nikki Haley. Në fund, ajo e falënderon Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së dhe i thotë se pret me padurim "të vazhdojmë të punojmë bashkërisht për të ndihmuar në mbështetjen e përpjekjeve për paqe në Kosovë dhe në mbarë botën".

(Koha DITORE, 17 tetor)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### KU KA QENË PASARONI?

Pasaroni ka qenë kryeqendër e Molosisë, krahinë e fisit epirot të molosëve në Epir. Rrënojat e tij ndodhen në malin Rodotopi, 12 km në veriperëndim të Janinës. Pasaroni njihet si qyteti ku ishte altari i Zotit të luftës, ku mbretërit molosë e kishin zakon të bënin fli pasi merrnin pushtetin. Duke mbrojtur interesat e klasës sunduese, këtu ata betoheshin përpara përfaqësuesve të shtetasve të vet se do të sundonin sipas ligjeve, ndërsa



përfaqësuesit nga ana e tyre betoheshin se do ta përkrahnin mbretin për sa kohë që do të respektonte këto ligje. Pasaroni duhet të ketë qenë një nga 70 qytetet që u shkatërruan nga Pal Emili më 167 p.e.s.



Një pjesë e madhe e deputetëve të paraqitur për fjalë janë tërhequr, ndërsa e sigurt mbetet se siguri votimi do të ndodhë të premtën. Në shumicën parlamentare janë rritur shpresat se mund të sigurohen 80 votat e nevojshme për të votuar ndryshimet kushtetuese, ndërsa në mesin e VMRO-së janë ndërjerë lëkundje në grupin parlamentar

VAZHDON DEBATI PËR NDRYSHIMET KUSHTETUESE

# PUSHTETI KËRKON KONSENSUS, LËKUNDET VMRO



Shkup, 17 tetor - Në Parlament ka vazhduar debati për Propozimin për qasje drejt ndryshimeve kushtetuese. Në ditën e tretë të diskutimit për propozimin që deri në Parlament e dorëzoi Qeveria e Maqedonisë, ndërsa del nga Marrëveshja e Prespës, një pjesë e madhe e deputetëve të paraqitur për fjalë janë tërhequr, por me siguri votimi do të ndodhë të premtën. Në LSDM janë rritur shpresat se mund të sigurohen 80 votat e nevojshme për të votuar ndryshimet kushtetuese, ndërsa gjatë ditës së mërkurë në mesin e VMRO-së janë ndërjerë lëkundje në grupin parlamentar.

Deputetja Julijana Nikollova nga PLD ka thënë se përgjegjësia tani është te deputetët dhe se bashkë 120 deputetët duhet të qëndrojnë pas vendimit për NATO dhe BE. Sipas Nikollovës, problem më i madh i deputetëve të opozitës është qëndrimi partiak i VMRO-DPMNE-së të mos përkrahen ndryshimet kushtetuese me qëllim ndryshimi i emrit kushtetues.

Branko Manojlovi nga Bashkimi Demokratik për Integritet madje ka propozuar që ndaj çdonjërit, siç tha VMRO-ist i cili do të votojë për marrëveshjen, shteti të qëndrojë pas tyre, por së pari të votojë dhe të amnistohen të gjithë mëkatarët. "Gjithçka është ekonomi, para", ka thënë Manojlovi, i cili tha se duhet të shikohet në të ardhmen e jo në të kaluarën.

Për deputetët e VMRO-DPMNE-së, Marrëveshja e Prespës është e dëmshme dhe e vdekur politikisht dhe ligjërisht, ndërsa gjatë dakordimit të saj ka pasur mosrespektim të presidentit dhe dispozitave ligjore nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, ndërsa për shumicën par-

lamentare nuk mund të ketë marrëveshje më të mirë nga kjo dhe nëse refuzohet Maqedonisë i kanoset izolim afatgjatë dhe bllokimi i integritetit në BE dhe NATO. Kryeministri Zoran Zaev ndërkohë porositi se procesi i negociatave me Greqinë është zhvilluar në mënyrë më transparente deri më tani dhe për çdo hap është informuar shefi i opozitës, liderët e partive më të mëdha politike dhe presidenti i shtetit, deri në kornizat me të cilat nuk janë shkelur strategjitë negociuese.

"Jam i vetëdijshëm se nuk i kam 80 deputetë. Bëra gjithçka që munda të bëj për të pasur proces inkuziv. Sot sjellim vendim për të dhënë shans që të hapet procedura, ndërsa në fund nuk duhet t'i votojmë ndryshimet kushtetuese nëse diçka është rrezikuese dhe e fshehtë. Kush na ka dhënë të drejtë unë dhe Dimitrov të përgatisim amendamente. Ne nuk guxojmë të prekim

derisa Parlamenti nuk lejon, se atëherë do ta dhunojmë demokracinë dhe procedurën në shtet. Premtoj se së bashku do t'i punojmë me të gjithë ju. Nëse nuk dakordohemi keni të drejtë të mos i votoni", potencoi Zaev.

Ai përmendi se Qeveria është vetëm propozues i autorizuar i amendamenteve kushtetuese dhe është e obliguar deri te Komisioni nëse këtë e pranon Parlamenti në afat prej 15 ditëve të përpilohet projekt-amendament. Këtu jam si njeriu i parë i Qeverisë, të konfirmoj se bashkërisht do të ulemi t'i përpilohet amendamentet. Qëllimi është, siç tha, të gjendet marrëveshje e cila çon drejtë miqësisë dhe nuk do të lenë gjurmë të reja që në të ardhmen qeveri të Maqedonisë dhe Greqisë, të kenë pakënaqësi shtesë.

Se Qeveria kërkon konsensus për ndryshimet kushtetuese, e ka konfirmuar edhe zëdhënësi i Qe-

risë, Mile Boshnjakovski. "Qeveria do t'i qaset përpilimit të amendamenteve kushtetuese madje pasi të përfundojë me punën në Parlament me votimin e nevojës për përpilimin e tyre, ndërsa më së miri është që ato të përgatiten së bashku me opozitën, gjegjësisht të arrihet konsensus nacional", tha Boshnjakovski, pas mbledhjes së Qeverisë një ditë më parë. "Kryeministri Zaev tashmë tre ditë është në Kuvend. Të gjitha porositë janë thënë pastër dhe qartë nga foltorja e kuvendit. Duhet të ndërtohet konsensus nacional sepse siç thotë edhe kryeministri puna është tejet serioze. Amendamentet do t'i përpilohet Qeveria dhe më mirë është të përgatiten së bashku me opozitën gjegjësisht të arrihet konsensus nacional në frymë të Marrëveshjes së Prespës", tha Boshnjakovski në pyetjet e gazetarëve për qëndrimin e Qeverisë në lidhje me letrën nga ndihmës sekretari i shtetit të SHBA-së për Evropën dhe Azinë, Ues Miçell, deri te lideri i VMRO-DPMNE-së dhe nëse është i mundur takim Zaev-Mickoski. Sa i përket mënyrës me të cilën do të formulohen amendamentet dhe çfarë do të përfshijnë, do të bëhen të ditura sapo të përfundojë votimi në Kuvend, tha Boshnjakovski duke potencuar se nuk dëshiron të spekulohet për përmbajtjen e tyre. Për letrën nga Miçel drejtuar Mickoskit, zëdhënësi i Qeverisë tha se kjo është e qartë vetvetiu dhe nuk ka çfarë të shtohet.



## Mickoski i përgjigjet Miçelit: Marrëveshja kundër kombit tim, e papranueshme për VMRO-në

Shkup, 17 tetor - Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski, sot iu është përgjigjur letrës së ndihmës sekretarit të SHBA-ve, Ves Miçell, i cili një ditë më parë, tha se ishte i zhgënjyer me veprimet e VMRO-së dhe udhëheqës të saj në lidhje me referendumin mbi Marrëveshjen e Prespës, por edhe mbi qëndrimin kundër ndryshimeve kushtetuese në Parlament.

Në përgjigje, Mickoski shkruan se Marrëveshja për emrin është e dëmshme për interesat e kombit maqedonas dhe atdheun e tij, dhe si e tillë, shkruan Mickoski, është e papranueshme për VMRO-DPMNE-në dhe për shumicën dërmuese të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë që bojkotuan referendumin e 30 shtatorit.

"Marrëveshja është e dëmshme për interesat e kombit tim dhe atdheut tim dhe si e tillë është e papranueshme për VMRO-DPMNE-në dhe për shumicën dërmuese të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, që u dëshmuar edhe në referendumin e fundit", shkruan në përgjigje Mickoski. Lideri i VMRO-së në letër ka akuzuar Qeverinë e Zoran Zaevit, ndërsa kryeministrin e cilëson si fajtor kryesor për gjendjen në të cilën ndodhet marrëveshja për emrin, sepse siç shkruan Mickoski, Bashkësisë Ndërkombëtare i ka premtuar diçka që nuk mund ta bëjë.

"Shpresoj që Maqedonia së shpejti të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së, por krenare dhe dinjitoze, jo e turpëruar, e deformuar dhe e turpëruar", shkruan mes tjerash në përgjigje Mickoski.

## DIMITROV: BISEDIMET TENSIONUESE PËR HISTORINË

Bisedimet mes Bullgarisë dhe Maqedonisë për momentet kontestuese nga historia e përbashkët do të jenë të tensionuara, por presim të arrijmë rezultate, ka deklaruar profesori Angel Dimitrov i cili është kryetar i palës bullgare të Komisionit të përbashkët të ekspertëve për çështje historike dhe arsimore me Maqedoninë. "Puna do të jetë tensionuese dhe nuk do të zhvillohet shpejtë siç duam, por me pritje se do të arrijmë rezultate. Nuk ka pretendime të mëdha nga ana e kolegëve nga Shkupi, vërejtjet tona janë të shumfishta, por ka të ndërtaura pozicione që në diskutimin shkencor

nuk ndryshohen lehtë", ka thënë për fillimin e bisedimeve Dimitrov i cili është historian dhe ish ambasador i Bullgarisë në Shkup. Komisioni ka filluar me shqyrtimin e librave për arsimin fillor. "Këto libra e shqyrtojnë historinë nga antika deri në atë mesjetar. Vërejtjet tona ishin të koncentruar mbi mesjetën ku krijohet lidhja e shtetit bullgar me territorin gjeografik të Maqedonisë. Ndryshimi është kompleks, i kontrolluara edhe librat për gjimnaz dhe për kohën e re do të kemi punë edhe më serioze", ka thënë Dimitrov në deklaratën për BTB.



Athinë, 17 tetor - Kryeministri grek Alexis Cipras e pranoi dorëheqjen

e ministrit të Punëve të Jashtme, Nikos Koxias dhe i shprehu falën-

## Cipras e pranoi dorëheqjen e Koxiasit

derim për kontributin e tij në Qeveri dhe për vendin në 3.5 vitet e gjysmë, kumtoi Kabineti i kryetarit të Qeverisë greke. Ministrinë e Punëve të Jashtme do ta ndër-marrë kryeministri i Greqisë me qëllim që, siç thuhet nga kabineti i Ciprasit, "të ndihmojë me të gjitha forcat në përfundimin me sukses të Marrëveshjes së Prespës". Ndryshe, mediat në Athinë

kanë raportuar se dorëheqja e Koxiasit ka ardhur si rezultat i një konflikti të brendshëm, që nuk është i ri, por që ka kulmuar pas vizitës së fundit në SHBA të ministrit të Mbrojtjes, Panos Kamenos, njëkohësisht kreu i partisë aleate në Qeveri.

Ky i fundit, që ka propozuar një marrëveshje ushtarake midis Greqisë dhe vendeve fqinje si mbu-

rojë ndaj Rusisë, në rast dështimi të miratimit të Marrëveshjes së Prespës në Parlamentin e Maqedonisë, ka hedhur kritika ndaj ministrit të Jashtëm, Nikos Koxias. Kjo ka sjellë në mbledhjen e qeverisë një debat të ashpër midis dy ministrave dhe Alexis Cipras ka ndarë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë mes dy partnerëve.

(R.K)



## E përplas këmbësorin, shoferi ik nga vendi i ngjarjes

Shkup, 17 tetor - Në udhëkryqin mes rrugës "Luka Gerov" dhe "Mark Tuen" në Shkup dje një automjet i panjohur i drejtuar nga shoferi i panjohur është përplasur në këmbësorin S.S. (58) nga Probishtipi, pas çka ka ikur nga vendi i ngjarjes. Siç kumtoi MPB-ja, nga goditja S.S. ka marrë lëndime të rënda trupore dhe me automjet tjetër është dërguar në spitalin e përgjithshëm të qytetit "8 Shtatori" ku i është dhënë ndihmë mjekësore dhe është mbajtur për mjekim të mëtutjeshëm. Po ndërmerren masa për gjetjen e automjetit së bashku me shoferin dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

## Krizë në tregtinë me pakicë

Shkup, 17 tetor - Udhëheqësit e subjekteve afariste në tregtinë me pakicë vlerësojnë se gjendja ekonomike në tremujorin e tretë të këtij viti është më e pavoritshme në krahasim me atë paraprak, dhe në krahasim me tremujorin e tretë të vitit të kaluar, publikoi Enti Shtetëror i Statistikës. Sipas të dhënave të publikuara pritet që gjendja ekonomike në këto ndërmarrje të jetë më e pavoritshme edhe në dy tremujoret e ardhshme. "Sasia e tepricave është rritur në krahasim me tremujorin paraprak. Gjendja financiare në tremujorin e tretë të vitit 2018 është më e pavoritshme në krahasim me tremujorin e dytë të vitit 2018, vlerësimi për porositë e pritura për periudhën e ardhshme është në e volitshme, ndërsa pritjet për numrin e të punësuarve janë se ai do të ulët", theksojnë nga Enti Shtetëror i Statistikave. Çmimet shitëse në tremujorin e tretë të vitit 2018 janë rritur në krahasim me atë paraprak, ndërsa pritet rritja e tyre edhe në tre muajt e ardhshëm. Ndikim më të madh mbi përkufizimin e gjendjes ekonomike në subjektet afariste gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 kanë pasur kërkesë të ulët nga blerësit me 22,8 për qind, konkurrenca e rritur e tregut me 19,1 për qind, mungesa e kuadrit të trajnuar me 15,5 për qind është rritur oferta e tregut me 14 për qind.

Zonat me boom-in më të madh sa i takon lindjes së fëmijës së tretë është Shkupi (9562 fëmijë) dhe Pollogu (4291 fëmijë). Dallimi me vitin paraardhës është i madh, sidomos për rajonin e Shkupit ku numri i fëmijëve është më i madh se 1100. Por pavarësisht rritjes së numrit të familjeve që vendosin të kenë "fëmijën e tretë", numri i lindjeve të fëmijës së parë apo të dytë vjen gjithnjë duke u reduktuar, e për rrjedhojë, edhe rritja natyrale e popullsisë ecën me ritëm të ngadaltë

Koha Evis HALILI

Shkup, 17 tetor - Numri i fëmijëve të lindur si të tretë me radhë në familje ka pësuar rritje. Vetëm gjatë vitit të kaluar, shifrat kanë arritur në rreth 26.700 fëmijë, të cilët përfitojnë një shumë mujore (8250 denarë), që do të thotë mbi 2800 fëmijë më shumë sesa një vit më parë. Sipas të dhënave më të fundit zyrtare, zonat me boom-in më të madh sa i takon lindjes së fëmijës së tretë janë Shkupi (9562 fëmijë) dhe Pollogu (4291 fëmijë). Dallimi me vitin paraardhës është i madh, sidomos për rajonin e Shkupit ku numri i fëmijëve është më i madh se 1100. Një situatë e ngjashme është edhe në rajonin e Pollogut ku janë regjistruar 500 fëmijë më shumë.

## KONFERENCË SHKENCORE NË UNIVERSITETI NËNË TEREZA

### Shqiptarët, shembull i tolerancës multikulturore

Akademikët dhe politikanët vlerësojnë fenomenin e multikulturores, multilingualizmit dhe interkulturalizmit që nga koha e Skënderbeut, kurse ky fenomen duhet të përcillet brez pas brezi, për të dëshmuar civilizimin tonë dhe bindjet pro evropiane të popullit shqiptar

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 17 tetor - Dhjetëra studentë shqiptar, akademik, profesorë dhe funksionarë shtetëror morën pjesë në seminarin shkencorë

## MBI DY MIJË FOSH NJE ÇDO VIT

# VAZHDON "BABY BOOM"

## ME TË TRETIN



Nga masat e Qeverisë më së shumti kanë përfituar familjet shqiptare (rreth 10 mijë), të cilat kryesojnë listën e shfrytëzuesve të këtyre shtesave mujore, ndërsa pjesa tjetër janë maqedonas (mbi 6 mijë) dhe nga etnitë e tjera.

Masat ligjore dhe stimulimi financiar për të lindur fëmijën e tretë e të katërt nuk arritën gjatë këtyre dhjetë viteve të ndryshonte pasqyrën e natalitetit, përveç disa ndryshimeve të vogla në vitet e para të aplikimit. Për shembull, nëse në vitin 2010 mbi 5 mijë fëmijë përfitonin nga shtesa mujore, ky numër u katërfishua pas pesë vitesh. Në vitin 2015 numëroheshin 21 mijë fëmijë, ndërsa në vitin 2016 rreth 24 mijë fëmijë. Pasqyrat statistikore japin një shpjegim të qartë se pse shtimi natyror i popullsisë ka ritëm të ngadaltë dhe procesi i plakjes është i pakthyeshëm. Numri i foshnjave në që lindin gjatë një viti në Maqedo-

ni është i vogël, sidomos po të krahasohet me fillimin e viteve 1990 ku numëroheshin rreth 30 mijë të sapolindur, këto shifra janë reduktuar në maksimum viteve të fundit dhe mezi arrijnë deri në 20 mijë foshnje në vit. Pavarësisht rritjes së numrit të familjeve që vendosin të kenë "fëmijën e tretë", numri i lindjeve të fëmijës së parë apo të dytë vjen gjithnjë duke u reduktuar, e për rrjedhojë, edhe rritja natyrale e popullsisë ecën me ritëm të ngadaltë. Kjo është arsyeja që demografët i cilësojnë këto shifra si zhgënjyese, ndërsa projektet e ndërmarra nga Qeveria për të stimuluar lindjet si të dështuara.

Nëse në vitin 2010 mbi 5 mijë fëmijë përfitonin nga shtesa mujore, ky numër u katërfishua pas pesë vitesh. Në vitin 2015 numëroheshin 21 mijë fëmijë, ndërsa në vitin 2016 rreth 24 mijë fëmijë



Nga ana tjetër, shtimi i pjesëtarëve të familjes nënkupton rritjen e varfërisë. Sipas statistikave dhe indikatorëve të varfërisë në Maqedoni familjet me mbi pesë anëtarë jetojnë në varfëri. Për dallim nga ato të tjerat që numërojnë tre, apo katër anëtarë, që do të thotë se me rritjen e numrit të fëmijëve gjatë këtyre viteve për pjesën më të madhe të familjeve është thelluar hendeku i varfërisë. Për momentin stimulimi i natalitetit bëhet vetëm për fëmijën e tretë, në një vlerë prej mbi tetë mijë denarë dhe një kohëzgjatje prej dhjetë vitesh. Ndërsa për fëmijën e katërt përfitojnë vetëm ato që kanë lindur deri në fund të 2009.

donase, ndikimi i kulturës mbi ndarjen territoriale dhe shumë punime të tjera lidhur me këtë temë. Të gjitha punimet seminarike të cilat u prezantuan sot, do të botohen në revistën "Komunikimi Multikulturore".

Luan Starova dhe Rubin Zenon shtjelluan ndikimin dhe kontributin e rilindësve mbi këto vlera, që nga Faik Konica, Sami Frashëri, Jeronim De Rada të cilët tolerancën kulturore dhe gjuhësore e kishin shprehur në botimet e tyre në revistën prestigjioze "Albania", ku kishin botuar në gjuhë të ndryshme por gjithmonë duke lobuar për identitetin, problematikat dhe çështjen shqiptare.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi i cili tha se këto tri koncepte janë përbërës kryesor të ngritjes dhe përparimit të një shoqërie, sepse të bashkëjetosh me kultura të ndryshme është avantazh dhe guxim dhe jo shkak për të nxitur konflikt.

Zv.ministri i ASH, Petar Atanasov theksoi se qeveria ka formuar grup i udhëhequr nga profesor Rubin Zenon që pritet të kontribuojë në hapjen e temave rreth këtyre vlerave, për të mundësuar jetesë dhe respekt midis të gjithë kulturave në shtetin e Maqedonisë.

Ndërkaq, ministri i Kulturës, Asaf Ademi e vlerësoi figurën e Skënderbeut si shembull tipik i multikulturalizmit dhe multilingualizmit i cili duhet ndjekur. Ademi theksoi se njohja e gjuhës së tjetrit, e kulturës së tij dhe bashkëjetesa në kushte të tilla, janë tipar me të cilin ne mund të mburmi edhe para vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Evropian dhe dallimet e tilla duhet të bëhen ura komunikimi dhe ndërkëmbimi.

Mesazhi për popullin shqiptar nga ana e akademikëve e cila përcjellët me breza të tërë ngelet i qartë, tolerancë dhe mirëkuptim për të treguar civilizimin tonë shekullor dhe pro perëndimor.



## DËSHMITARI I RREZIKUAR DHE OPINIONI



## GJYKATAT ME QASJE SELEKTIVE

Qëndrimet e ekspertëve të jurisprudencës së gjykata e Maqedonisë nuk i zbatojnë praktikën vendase dhe ato ndërkombëtare, më së miri e sqaron veprimi i Gjykatës Penale e Shkupit e cila brenda dy muajve, për lëndë të ngjashme, miraton dy vendime të ndryshme. Kështu ajo në gusht të këtij viti përveç opinionit të ekspertëve, në seancën për rastin "Monstra" ku u prezantua dëshmitari i rrezikuar "E-1" e lejoi prezencën e mediave dhe publikut të thjeshtë

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 17 tetor - Mos lejimi i opinionit për të dëgjuar rrëfimin e dëshmitarit të rrezikuar "S-1", në rastin e 27, është në kundërshtim me kornizën e brendshme ligjore dhe praktikën e vendosur nga Gjykata ndërkombëtare penale, respektivisht Gjykata e Hagës. Ky reagim vjen nga "Koalicioni për gjykim të drejtë", të cilët në vazhdimësi i monitorojnë proceset gjyqësor pranë Gjykatës Themelore Shkupit 1, respektivisht të njëjtit së bashku me gazetarët gjatë dy ditëve të kaluara nuk u lejuan të prezantojnë në brenda sallës gjyqësore për 27 prillit.

"Përkundër faktit se neni 354 i Ligjit për procedurë penale, (LPP) parasheh që dëgjimi i dëshmitarit të rrezikuar nuk është bazë për largimin e opinionit,

megjithatë kjo dispozitë ligjore e jep mundësinë e përjashtimit të opinionit në rast se rrezikohet siguria e dëshmitarit. Ajo që duhet të theksohet është se përmbajtja e këtij ligji është e përgjithshme dhe i dedikohet atyre dëshmitarëve, (për të cilët nuk janë paraparë Masa të Posaçme Hetuese) gjegjësisht në këto rrethana është dhënë mundësia që gjykata ta largoj opinionin, në rast se ekziston rreziku real për sigurinë e dëshmitarit", njoftojnë nga Koalicioni për gjykim të drejtë.

Duke e elaboruar vendimin e padrejtë të Gjykatës Themelore Shkupit 1, nga ky Koalicion, shtojnë se edhe pse ekziston dispozita e sipër përmendur, LPP-ja përmban dispozita special të cilët ekskluzivisht kanë të bëjnë me dëgjimin dhe sigurimin e dëshmitarëve të rrezikuar. Kryetarja e Koalicionit në fjalë, juristja, Natalia Petrovska, ka theksuar LPP-ja në nenin 228, e ka rregulluar çështjen për mbrojtjen e dëshmitarit të rrezikuar gjatë shqyrtimi kryesor.

"Sipas kësaj norme ligjore dëshmitarët e rrezikuar dëgjohen në mënyrë të posaçme, me çka paragrafi 4, i nenit 228 parasheh, (mënyrë e posaçme e dëgjimit) e cila mund të realizohet mbulimin e identitetit, dhe në raste të caktuara edhe pamjen e dëshmitarit. Kështu që sipas këtij neni mundësohet siguria e dëshmitarit të rrezikuar nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale dhe identitetit. Kjo dispozitë ligjore nuk e njeh mundësinë e largimit të opinionit nga seanca për shkak të sigurisë së dëshmitarit, për arsye se fillimisht dëshmitari i rrezikuar duhet të mbrohet nga të akuzuarit dhe jo nga opinion", thonë nga Koalicioni për gjykim të drejtë.

Gjatë numrit të dispozitave të LPP-së

ku nuk parashihet largimi i opinionit nga dëgjimi i dëshmitarit të rrezikuar, nga Koalicioni për gjykim të drejtë kanë thënë se nenet 229 dhe 230, pikërisht për arsye të sigurisë parashohin masa të posaçme të dëgjimit të kësaj kategorie të dëshmitarëve. Mes tjerash Këshilli Penale, i kryesuar nga gjykatësja Dobrila Kacarska, gjatë largimit të opinionit nuk e ka pasur parasysh praktikën e Gjykatës ndërkombëtare penale dhe Gjykatës së Hagës, rregullat e të cilëve parashohin që varg masash për sigurimin e identitetit të dëshmitarit të rrezikuar

"Rrëfimi përmes video linçeve, me zë dhe fytyrë të fshehur. Përderisa largimi i opinionit nga salla gjyqësore mund të zbatohet posaçërisht në ato raste kur ekziston mundësia e publikimit të sekreteve dhe informacioneve private për publikun", reagojnë nga Koalicioni për gjykim të drejtë.

Qëndrimet e ekspertëve të jurisprudencës së gjykata e Maqedonisë nuk i zbatojnë praktikën vendase dhe ato ndërkombëtare më së mirë e sqaron veprimi i Gjykatës Penale e Shkupit e cila brenda dy muajve, për lëndë të ngjashme, miraton dy vendime të ndryshme. Kështu ajo në gusht të këtij viti përveç opinionit të ekspertëve, në seancën për rastin "Monstra" ku u prezantua dëshmitari i rrezikuar "E-1" e lejoi prezencën e mediave dhe publikut të thjeshtë. Ndërsa dy muaj më pas, gjatë rrëfimit të dëshmitari "S-1" në rastin e 27 prillit ajo publikun e largoi nga salla, me përjashtim të përfaqësuesve të OSBE-së dhe atyre të SHBA-ve. Dallimi mes këtyre të dy rasteve është se aktakuzën për "Monstrën" e përfaqëson Prokuroria Speciale Publike, ndërsa 27 prilli shqyrtohet nga Prokuroria për krim të organizuar.

## KRONIKË

## Paditet hajni i Shkupit

Sektori për Punë të Brendshme në Shkup deri te Prokuroria publike ka ngritur kallëzim penal kundër S.P (32) nga Shkupi i cili akuzohet se ka kryer grabitje në një farmaci me përfitim të paligjshëm pronësor prej rreth 35 mijë denarë. I paraqituri S.P. njofton MPB më 3.10.2018 rreth orës 20:50 në barnatoren në rrugën "Luka Gerov" duke e kërcënuar me thikë nga e punësuar ka marrë 35 mijë denarë nga arka ku dhe është larguar. Pas masave dhe aktiviteteve të ndërmarra, S.P. është privuar nga liria më 12.10.2018. Në bisedë me nëpunës policor i paraqituri ka pranuar veprën, ndërsa ka treguar edhe vendet ku i ka hedhur sendet që ka bartur me vete gjatë kryerjes së veprës penale. Më 13.10.2018 në bazë të urdhrit gjyqësor është kryer bastisje në shtëpinë e të paraqiturit.

## 33-vjeçari plagos bashkëfshatarin

Q.E. (56) nga fshati Saraqinë i Tetovës është plagosur me plumb në gjurin e djathtë pasi dje drejt tij me pistoletë ka shtënë bashkëfshatarin i tij P.P. (33), informoi zëdhënësi i SPB Tetovë Marjan Josifovski. Sipas denoncimit në polici incidenti i armatosur ka ndodhur dje rreth orës 7:30 me ç'rast P.P. derisa ka lëvizur me "Golf" me targa tetovare nga pistoletë ka shtënë dy plumba drejt Q.E., i cili ka ecur në këmbë në afërsi të shtëpisë së tij. Madje njëri nga plumbat e ka goditur Q.E. në gjurin e djathtë, me ç'rast P.P. me automjetin është larguar nga vendi i ngjarjes. I lënduari Q.E. me automjet të ndihmës urgjente mjekësore është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës dhe është mbajtur në mjekim të mëtejshëm. Pas autorizimit të prokurorit publik ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekip i SPB Tetovë. Në vendin e ngjarjes është gjetur gëzhojë të kalibrit 7,65 milimetra që është dërguar për ekspertizë. Policia po ndërmerr masa për gjetje të P.P. dhe për ndriçim të plotë të rastit, tha Josifovski.

## Sërish plaçkitet një bastore në Gostivar

Të martën mbrëma një person i panjohur ka kryer plaçkitje në një bastore sportive në qytetin e Gostivarit. Plaçkitësi, sipas policisë, duke kërcënuar të punësuarin me pistoletë, i ka marrë 15.0810 denarë dhe është larguar në drejtim të panjohur. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

## Sulmojnë policët, arrestohen dy persona

Tre pjesëtarë të Policisë së Gostivarit, në rrugën "Be-liçica" në Gostivarit, kanë ndaluar veturën Reno me targa të Gostivarit, e drejtuar nga personi me iniciale XH.Z. Më pas, nga vetura kanë dalë E.A 33-vjeçar dhe S.I 21-vjeçar nga Gostivari dhe kanë filluar në mënyrë agresive të sillen, ndërsa kanë tentuar të sulmojnë fizikisht pjesëtarët e policisë. Të dy personat janë arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor në Gostivar.

## Aksidentohet 23-vjeçari në Tetovë

Të martën rreth orës 14, në bulevardin "Vidoe Smilevski Bato" në Tetovë, një veturë me targa të Tetovës ka goditur këmbësorin M.B 23-vjeçar. Nga goditja, këmbësori ka marrë lëndime dhe me veturë tjetër është dërguar në Klinikën e Tetovës ku i është dhënë ndihma e parë dhe është mbajtur për shërim të mëtejshëm. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes. (U.H)

## Shkup, 18 të lënduar në 18 aksidente

Shkup, 17 tetor - Dy këmbësorë, një vozitës i automjetit dhe një udhëtar në autobus kanë marrë lëndime të rënda trupore, ndërsa 14 lëndime më të lehta në gjithsej 18 fatkeqësi rrugore që ndodhën në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në gjashtë fatkeqësi është shkaktuar vetëm dëm material.

Sipas buletinit të SPB Shkup, 23 vozitës kanë lëvizur me shpejtësi më

të madhe se e lejuara, 27 vozitës janë përjashtuar nga komunikacioni, nga të cilët dy për shkak se e kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 20 vozitës kanë vozitur para se të pajisen me patentë shoferi dhe pesë vozitës fillestarë.

Janë përjashtuar nga komunikacioni edhe 18 automjete të pargjistruara. Në mënyrë jo të rregullt kanë

qenë të parkuara 85 automjete, ndërsa me karrotrecin janë mënjeluar 71 automjete.

Policia ka sanksionuar edhe një këmbësor i cili ka kaluar në dritë të kuqe të semaforit, gjashtë vozitës të cilët kanë kaluar udhëkryqin në dritë të kuqe, dhe tre për mospërdorim të rripit të sigurimit nga vozitës me motor, skuter dhe motoçikletë.



DËSHTON EDHE TENDERI I DYTË I MTL

# WIZZ AIR NUK I KA PËRMBUSHUR KRITERET

Pesë milionë euro të parapara nga Qeveria si subvencion për tre vitet ardhshme e presin kompaninë që do të nënshkruajë marrëveshje për vendosjen e gjashtë destinacioneve të reja, dy nga aeroporti i Shkupit dhe katër nga aeroporti i Ohrit



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 17 tetor - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve sërish e anuloi shpalljen publike për subvencionim financiar të kompanive ajrore. Në këtë shpallje sërish ofertë kishin dorëzuar vetëm kompania ajrore Wizz Air, e cila aktualisht edhe pse i ka skaduar marrëveshje që në korrik të këtij, vazhdon të bartë udhëtarë nga aeroporti i Shkupit dhe Ohrit dhe anasjelltas drejt destinacioneve të ndryshme të vendeve të BE-së dhe botës.

Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski në një

konferencën për media, informoi se deri në afatin përfundimtar është dorëzuar ofertë vetëm nga Wizz Air, por ajo nuk përshtatet me kushtet dhe kriteret në tender.

"Kompania ajrore Wizz Air, ka dorëzuar ofertë në të cilën të katër destinacionet nga aeroporti 'Shën Apostol Pavle' në Ohër, planifikon t'i vendos në gusht të vitit 2019 që është në kundërshtim me një prej kriterëve kryesorë në tender. Në shpalljen publike qartë qëndron se kompania ajrore e ka për obligim deri më 10 janar të vitit 2019 të vendos dy linja nga aeroporti në Ohër

edhe dy në afat prej një viti nga nënshkrimi i marrëveshjes. Kompania ajrore Wizz Air ka ofruar të gjitha katër destinacionet t'i vendos në gusht të vitit 2019. Për shkak kësaj, komisioni ka konstatuar se kushtet nga shpallja publike nuk janë plotësuar dhe ka dhënë rekomandim kjo shpallje të anulohet", tha Sugareski, i cili njoftoi se kompanitë tjera nuk kanë dorëzuar oferta.

"Është e vërtet se në bisedimet që ka pasuar Qeveria me kompanitë tjera ajrore, është shprehur gatishmëri të ofrohet ofertë si në shpalljen e parë dhe te dytën, por

në realitet kjo nuk ndodhi. Se cilën janë arsyet për mos interesim të kompanive tjera ajrore, i dinë vetëm ata dhe se Qeveria aspak nuk ka ndërmend të merret me politikën afariste që kanë këto kompani", tha Sugareski.

Ai gjithashtu informoi se 5 milion euro të parapara nga Qeveria si subvencion për tre vitet ardhshme presin kompaninë që do të nënshkruan marrëveshje për vendosjen edhe gjashtë destinacioneve të reja, 2 nga aeroporti i Shkupit dhe katër nga aeroporti i Ohrit.

"Qeveria mbetet konsekuente

në masën për mbështetje financiare për kompanitë ajrore të cilat do të ofrojnë destinacione të reja për qytetarët e Maqedonisë dhe se mjetet për subvencionim tashmë janë paraparë në buxhetet. Së shpejti do të publikojmë edhe shpalljen e tretë po më të njëjtat kushte si në shpalljen e parë dhe të dytën", tha Sugareski. Në pyetjen se pse pas skadimit të marrëveshjes, Wizz Air vazhdon të bartë udhëtarë në realizacione të ndryshme dhe për këtë a ka marrë leje nga Qeveria, sepse ka të publikuar në ueb faqen e tyre fluturimet deri në fund të vitit 2019, ministri Sugareski mohoi të ketë marrëveshje të re me këtë kompani, ndërsa për fluturimet nuk merr subvencione nga shteti.

"Wizz Air-it nuk i është vazhduar marrëveshja, as që ka marrë leje prej Qeverisë. Si kompani ajrore ajo ka të drejtë të organizojë fluturime, mirëpo për këto fluturime nuk do të merr subvencione nga shteti", tha ai. Ndërkaq sa i përket se 5 milionë euro nëse janë të mjaftueshme që Maqedonia të formojë kompaninë e vetë nacionale, Sugareski u shpreh se ende po bëhen analiza nëse formimi i kompanisë shtetërore ajrore është e leverdishme, ndërsa përmendi se 5 milionë që shteti i jep si subvencione për kompanitë e huaja, janë të mjaftueshme.

Në bazë të Programit për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural, në vitin 2018 ofrohen më shumë investime që ndahen në tre masa kryesore si "Përmirësimi i cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale", "Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave", si dhe "Ruajtja dhe avancimi i vlerave tradicionale në viset rurale"

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 17 tetor - Komunitat në Maqedoni kanë mundësi që me të hollat të pakthyeshme të përmirësojnë qasjen e bujqve deri tek tokat pjellore. Për këtë qëllim ato kanë në dispozicion 10 milion denarë për rikonstruimin apo hapjen e rrugëve të reja deri tek hapësirat bujqësore, ndërsa mjetet janë pjesë e Programit kombëtar për zhvillim rural, apo janë mjetet nga arka e shtetit.

MJETE TË PAKTHYESHME PËR RRUGËT

## QASJE MË E LEHTË DERI TEK FUSHAT PJELLORE



Gjithashtu po bëhen përgatitje që agjencia që menaxhon mjetet e lparit dhe të zhvillimit rural të akreditohet për infrastrukturën rurale publike ku për herë të parë komunitat në Maqedoni do të mund të shfrytëzojnë mjetet për zhvillimin e vendbanimeve rurale me mjete evropiane.

"U bëj thirrje të gjithë komunave që të aplikojnë për këto mjete deri më 17 nëntor dhe të aplikojnë me propozim projektet me qëllim me këto mjete për investime kapi-

taletë përmirësojnë kushtet e jetesës së bujqve dhe të lehtësojnë punën në arra", thotë Nikollçe Babovski, drejtori i Agjencisë për Përkrahje Financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

Sipas tij, një komunë në maksimum mund të shfrytëzojë tre programe të ndryshme me vlerë deri në maksimum 1 milion denarë. Vetëqeverisjet lokale të hollat do të mund të shfrytëzojnë për blerjen e materialeve ndërtimore, elementeve të rikonstruimit, pagesën e

mbikëqyrjes dhe realizimit të punëve ndërtimore, përgatitjen e elaborateve, studimeve të ndryshme, dhe dokumentacionit teknik. Babovski thotë se nuk ekziston ndonjë problem më i madh lidhur me aplikimin për fitimin e këtyre mjeteve.

"Aplikuesit duhet të dorëzojnë kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve, projekt themelor të reviduar, elaborat gjeodezik dhe miratim të Këshillit Komunal dhe kryetarit të komunës për dedikimin dhe prioritetin e investimit", shtoi më tej Babovski.

Lidhur me anulimin apo uljen e pagesës së TVSH-së për projektet evropiane duke marrë parasysh kondicionin e dobët financiar të komunale rurale të cilat nuk kanë në kufijtë e tyre administrativ, biznese të fuqishme që punësojnë me mijëra punëtorë apo që derdhin shuma të mëdha në arkën e komunës në emër të pagesës së tatimeve të ndryshme, Babovski në pyetjen e gazetës KOHA u përgjigj se institucioni që ai drejton nuk

është kompetent për zgjidhjen e këtij problemi.

Njëherazi komunitat nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e projekteve pa nënshkrimin paraprak të kontratës me Agjencinë e lparit, ndërsa të hollat paguhen pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimit të harxhimeve të investimit.

Në ndërkohë në bazë të Programit për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural, në vitin 2018 ofrohen më shumë investime që ndahen në tre masa kryesore si "Përmirësimi i cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale", "Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave", si dhe "Ruajtja dhe avancimi i vlerave tradicionale në viset rurale". Të gjithë këto masa janë të dedikuara për investime të ndryshme kapitale në infrastrukturën rurale

Ndryshe, vitin e kaluar vetëm mjetet për përmirësimin e rrugëve deri tek fushat i shfrytëzuan komunitat Kratovë, Vevčan, Pllasnicë, Bosillovë, Zrnovci, Koçanë, Debarcë, Gradsko, Vasillevë dhe Gradsko.



Shifra e varfërisë nuk është ndryshuar në raport me vitin e kaluar -21.9 për qind e qytetarëve janë të varfër ose në rrezik nga varfëria. Kjo, sipas Biljana Dukovska nga Platforma kundër varfërisë, do të thotë se rreth gjysmë milionë njerëz jetojnë në varfëri

MBËSHTETJE MË E MADHE PËR TË VARFRIT

# VARFËRIA, NJË E PESTA E POPULLATËS NË RREZIK



kyçe - për mbrojtje sociale dhe fëmijërore. Reforma është prezantuar dhe varësisht nga situata politike do të lëshohet në procedurë, që në afatin më optimal përmes përmes Qendrave për punë sociale të implementohet vitin e ardhshëm", tha ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Milla Carovska. Ajo përkujtoi se vendosen të

ardhura të garantuara për çdo familje apo individ që jeton në varfëri, e cila do jetë tre herë më e madhe nga ajo që e marrin tani, por siç tha, me qëllim që të aktivizohet e jo të harrohet.

Detyrim për atë do të kenë qendrat për punë sociale, të cilat do të jenë hallka kyçe për lidhjen me tregun e punës, për shkak se

siç tha, ka vende pune, por fuqi punëtore e kualifikuar dobët. Carovska tha se një pjesë e rëndësishme në zbatimin me varfërinë ka edhe sigurimi i shërbimeve sociale në nivel lokal.

Biljana Dukovska nga Platforma kundër varfërisë theksoi se është e domosdoshme që të ndërtohen partneritete aktive me personat që jetojnë në varfëri dhe në përjashtim social dhe t'i respektojmë kërkesat e tyre dhe nevojat kur krijohen politika që kanë të bëjnë me ta. Ajo potencon se shifra e varfërisë nuk është ndryshuar në raport me vitin e kaluar dhe se në vend 21.9 për qind e qytetarëve janë të varfër ose në rrezik nga varfëria, në pajtim me të dhënat e Entit për statistikë. Kjo, sipas Dukovskës, do të thotë se rreth gjysmë milionë njerëz jetojnë në varfëri.



## Mushkonja tigrë edhe në Maqedoni

Shkup, 17 tetor - Në territorin e Maqedonisë është detektuar mushkonjë aziatike-tigrë. Po bëhet lokalizim i gjithë territorit që të konfirmohet se ku është përhapur kjo mushkonjë. Agjencia po zbaton programe plotësuese për konfirmim eventual se nëse kjo mushkonjë ka bartur sëmundje tek kafshët, informoi në konferencën e djeshme për shtyp drejtori i Agjencisë për Ushqim dhe Veterinari, Zoran Atanasov, së bashku me epidemiologun nga Instituti për Shëndet Publik dr. Zharko Karaxhovski.

"Në pajtim me rezultatet që i kemi marrë, nuk ka konfirmim për ekzistimin e sëmundjeve të tilla dhe nuk ekziston rrezik i tillë", potencoi Atanasov. Sipas informatave të Agjencisë, informoi ai, kjo lloj mushkonje për herë të parë është detektuar në vitin 2016 vetëm në rajonin e Bogdancit, ndërsa sivjet është përhapur edhe në disa komuna në Shkup. Ai shpjegoi se specifika e mushkonjës është që të shumohet dhe të jetojë në temperatura të caktuara dhe në lartësi të caktuar mbidetare. "Kurthet janë vendosur sivjet në thuajse gjithë Maqedoninë Lindore, dhe po vazhdohet në pjesën tjetër të shtetit që të fitojmë fotografi të plotë për atë se nëse është përhapur edhe në rajonet e tjera", tha Atanasov dhe shtoi se është formuar grup parandalues në të cilin midis anëtarëve të tjerë janë edhe ai dhe ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe dhe në bazë ditore shqyrtohen të gjithë informatat.

Epidemiologu nga Instituti për Shëndet Publik, Zharko Karaxhovski informoi se deri më sot nuk është regjistruar asnjë rast i këtille infeksioni, e as sëmundje nga ky lloj i mushkonjës në Republikën e Maqedonisë. Duke përmendur se me zgjuarsin ndiqet gjendja në rajon dhe shtetet përreth, siç janë Serbia, Bullgaria, Greqia, Shqipëria dhe të tjera, informoi se atje janë regjistruar numër më i madh i personave të sëmurë, madje edhe raste vdekjeprurëse. Karaxhovski theksoi simptomat nga pickimi nga mushkonja tigrë janë skuqje në lëkurë, ënjtje, plogëshi, lodhje, kokëdhembje, temperaturë e lartë, por megjithatë, potencoi, se nuk do të thotë se bëhet fjalë për pickim nga kjo mushkonjë.

## ZAEV: PUNOJMË NË MËNJANIMIN E ARSYEVE PËR VARFËRINË

Investimi në asistencë sociale më të madhe për kategoritë më të ndjeshme të qytetarëve, në zhvillimin e hershëm të fëmijëve, qasje më të lehtë në shtesat fëmijërore, shtesë arsimi për fëmijët dhe rritje e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor, janë disa prej masave në realizimin e së cilave punon Qeveria për dalje nga rrethi i varfërisë, të cilat sot në Ditën Ndërkombëtare për Çrrenjosjen e Varfërisë i përkujtoi kryeministri, Zoran Zaev. "Duhet ta ndërpresim rrethin e varfërisë, që bartet nga gjenerata në gjeneratë midis familjeve më të ndjeshme. Për këtë, 11 mijë amvisëri plotësuese do të

fitojnë asistencë sociale të garantuar, krahas 26 mijë amvisërive ekzistuese të cilat kanë të drejtë për këtë kompensim. Familjet me fëmijë dhe me të ardhura të ulëta do të fitojnë qasje më të lehtë në Shtesën fëmijërore. Presim numri i fëmijëve të cilët do ta shfrytëzojnë këtë të drejtë të jetë mbi 70 mijë, për dallim prej vetëm 3.200 fëmijë të cilët tani kanë të drejtë për Shtesë fëmijërore", thotë Zaev në video-fjalimin. Sipas tij, zhvillimi i hershëm i fëmijëve është kyç dhe në të duhet të investohet në kohë dhe me përfshirjen e familjeve, pasi kjo nuk mund të kompensohet më vonë gjatë jetës.

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 17 tetor - Reformat që bëhen në sferën sociale për zvogëlimin e dhe çrrenjosjen e varfërisë duhet të jenë rrënjësore dhe të qëndrueshme, të bëra konform kërkesave dhe nevojave të të varfërve dhe personave në rrezik nga varfëria. Ata duhet të marrin më shumë mjete për ndihmë dhe mbështetje, por edhe të integrohen në shoqëri dhe në tregun e punës. Vetëm kështu do të mundësohet që ata të dalin nga gjendja në të cilën ndodhen.

Këto janë një pjesë e qëndrimeve të pjesëmarrësve në Konferencën për të varfërit dhe persona të përjashtuar nga shoqëria, që po mbahet me rastin e Ditës ndërkombëtare për çrrenjosje të varfërisë.

"Ne kemi qenë dëshmitarë se 11 vite varfëria dhe personat e shkyçur nga shoqëria janë keqpërdorur për shkaqe të ndryshme dhe se nuk janë miratuar politika që do ta ndryshojnë situatën në vend, por kemi pasur rritje të ndihmës nga dy, tre, pesë për qind që nuk ka dhënë efekt në uljen e varfërisë. Për këtë kemi punuar në dy ligjet

## NDAHEN CERTIFIKATAT E PARA PËR ZDRUKTHËTAR DHE MURATOR

# ME TRAJNIM DERI TE PUNËSIMI

Tetovë, 17 tetor - Persona të rinj dhe të papunë tashmë kryer trajnimin tremujor për zdrukthëtar dhe murator në kuadër të masës për trajnim tek punëdhënësi i njohur. Lupço Apostolovski, drejtor i Agjencisë për Punësim në Tetovë, thotë se madje dy persona kanë arritur të punësohen pas përfundimit të trajnimit.

"Ky është një aktivitet në kuadër të planit operativ të masave për punësim të të rinjve në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Arsimit, Agjencisë për Punësim dhe Shoqatës së Zejtarëve. Trajnimi që tash është realizuar është në kuadër të një subjekti të verifikuar nga fshati Leshkë. Në trajnim kanë marrë pjesë 10 persona, të cilët në mënyrë të suksesshme e kanë kryer, ku edhe dy persona tashmë



janë punësuar. Gjatë kësaj periudhe ka patur trajnime edhe për muratorë në Universitetin e Puntorëve në Tetovë. Këto trajnime janë pjesë e planit aktiv për punësimin e të rinjve, gjegjësisht për përmbushjen e nevojave të tregut të punës", tha drejtori Apostolovski. Personat që ndoqën këto trajnime gjatë kësaj periudhe kanë

marrë edhe subvencione nga shteti.

"Ky trajnim ka qenë për zdrukthëtarë, gjegjësisht 10 persona, kurse 7 persona të papunësuar kanë përfunduar trajnime për muratorë. Të gjithë kanë marrë certifikata dhe gjatë kohës sa ka zgatur trajnimi, ata kanë qenë të subvencionuar nga ana e agjenci-

së për punësim nga 9 mijë denarë në muaj dhe subjektet që i realizojnë trajnimet poashtu kanë marrë nga 30 mijë denarë për një person", deklaroi Apostolovski.

Nga kjo agjenci njoftuan se gjatë periudhës së ardhshme do të ketë trajnime edhe për zejet tjerë, për të gjithë personat e papunë të cilët do të shfrytëzojnë këtë mundësi që më lehtë të realizojnë idetë e tyre. "Një pjesë e atyre që kanë marrë certifikata tashmë kanë një rrefim të suksesshëm, sepse janë punësuar dhe besoj se në periudhën e ardhshme, do të kemi bashkëpunim më të mirë me subjektet e verifikuara të cilët i realizojnë trajnimet", thonë në këtë agjenci, duke ftuar të gjithë të papunët që të shfrytëzojnë këto trajnime që më lehtë pastaj të gjejnë punë. (U.H)





REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

**SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 221/2018**

për punësimin e 6 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë “për vendet e punës në vijim:

1. FZO0102B01002 Këshilltar i drejtorit 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
  - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike, Shkencat e Organizimit dhe Administrim (menaxhment)
  - më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
  - mësim dhe zhvillim
  - komunikim
  - arritje të rezultateve
  - punë me të tjerë/punë ekipore
  - ndërgjegjësim strategjik
  - orientim kah palët/palët e interesuara
  - udhëheqje; dhe
  - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
  - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
  - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë-e premte
  - Orët javore të punës 40
  - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
  - Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
  - Rroga neto: 32.825,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
2. FZO0102B01002 Këshilltar i drejtorit 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
  - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike, Arsim
  - më së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin publik, përkatësisht së paku 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
  - mësim dhe zhvillim
  - komunikim
  - arritje të rezultateve
  - punë me të tjerë/punë ekipore
  - ndërgjegjësim strategjik
  - orientim kah palët/palët e interesuara
  - udhëheqje; dhe
  - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
  - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
  - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Kushtet shtesë:**
- Të ketë status të personit me nevoja të veçanta (përdorues i pajisjeve ortopedike)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë-e premte
  - Orët javore të punës 40
  - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
  - Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
  - Rroga neto: 32.825,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
3. FZO0102B02001 Shef i kabinetit 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat e Mjekësisë
  - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
  - mësim dhe zhvillim
  - komunikim
  - arritje të rezultateve
  - punë me të tjerë/punë ekipore
  - ndërgjegjësim strategjik
  - orientim kah palët/palët e interesuara
  - udhëheqje; dhe
  - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
  - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
  - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë-e premte
  - Orët javore të punës 40
  - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
  - Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
  - Rroga neto: 28.370,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
4. FZO0102B04001 Koordinator i komisionit mjekësor, Shërbimi rajonale - Gostivar 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
  - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat e Mjekësisë
  - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
  - mësim dhe zhvillim
  - komunikim
  - arritje të rezultateve
  - punë me të tjerë/punë ekipore
  - ndërgjegjësim strategjik
  - orientim kah palët/palët e interesuara
  - udhëheqje; dhe
  - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
  - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
  - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë-e premte
  - Orët javore të punës 40
  - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
  - Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
  - Rroga neto: 28.370,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
5. FZO0102V03001 Bashkëpunëtor për menaxhim me burime njerëzore, Njësia për menaxhim me burime njerëzore, Sektori për menaxhim me burime njerëzore 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
  - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
  - Të jetë i moshës madhore,
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1 - Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike
  - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
  - mësim dhe zhvillim
  - komunikim
  - arritje të rezultateve
  - puna me të tjerë/puna ekipore
  - ndërgjegjësim strategjik
  - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
  - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
  - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë-e premte
  - Orët javore të punës 40
  - Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
  - Përshkrimi i orarit të punës: duke filluar mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi mes orës 15:30 dhe 16:30
  - Rroga neto: 22.431,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
- Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.**
- Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.
- Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.
- Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejt në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.
- Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



MINISTRI DAUTI QËNDROI PËR VIZITË NË TETOVË

# MBËSHTETJE PËR ZONËN EKONOMIKE TË TETOVËS

Sipas ministrit Dauti, në takim me drejtorin e kësaj Zone është biseduar për investimet potenciale dhe tërheqjen e sa më shumë investitorëve, ndërsa drejtuesve të Zonës së lirë ekonomike të Tetovës iu ka ofruar përkrahje institucionale për çfarëdo problematike që ato mund të hasin në tërheqjen e investitorëve



lirë ekonomike të Tetovës, Dauti iu ka ofruar përkrahje institucionale për çfarëdo problematike që ato mund të hasin në tërheqjen e investitorëve.

“Është vizita e parë e imja në Zonën e lirë ekonomike në Tetovë ku u njohëm me aktivitetet që zhvillohen në këtë zonë si dhe me investimet, të cilat aktualisht operojnë në këtë zonë. Diskutuam edhe për investimet potenciale, të cilat mund të vijnë në Zonën e lirë, kryesisht sipas Ligjit në fuqi që favorizon investimet brenda zonave industriale, pra që lejon investimet në prodhimtari që gjenerojnë punësime, rritje të eksportit dhe mirëqenie kolektive dhe sociale, ndërsa në këtë drejtim shkëmbyem informata të vlefshme. U ofrova përkrahjen time in-

stitucionale drejtuesve të Zonës për çfarëdo problematike që ato mund të hasin për sjelljen e investitorëve këtu në Tetovë, sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme të gjenerojmë një lloj mirëqenie për tetovarët dhe për të gjithë aplikantët e rinj që duan të punësohen në Zonën e lirë ekonomike të Tetovës”, tha ministri Dauti.

Drejtori i Zonës zhvillimore teknologjike industriale në Tetovë, Arben Halili, vlerësoi angazhimin dhe interesin e ministrit Dauti për Zonën, si dhe bashkëpunimin që në të ardhmen kjo zonë të ketë një zhvillim më të hovshëm.

“Duke marrë parasysh faktin që është vizita e parë e ministrit Dauti në Zonën e lirë ekonomike

të Tetovës, ne e informuam atë për mbarëvajtjen e punëve deri më tani, sigurisht se vlerësojmë edhe angazhimin dhe interesin e tij që edhe në të ardhmen ky bashkëpunim të jetë sa më i përafërt me të vetmin qëllim - të mundësojmë një zhvillim edhe më të hovshëm të Zonës së lirë ekonomike. Bashkëpunimi ngelet një mundësi dhe një alternativë edhe për në të ardhmen dhe sigurisht që tërheqja e investitorëve është në interesin e të dyja palëve, si në interesin tonë si kompani private që menaxhojmë me këtë zonë, po ashtu edhe në interes të vet shtetit”, tha Halili. Ministri Dauti shfaqti shpresë se kriza politike do të tejkalohet shumë shpejtë me qëllim që të mos ketë impakt në ardhjen e investitorëve të rinj.

## Donacion boshnjak për Gjinekologjinë e Shkupit

Shkup, 17 tetor - Gjashtëmbëdhjetë krevate të rinj për foshnje, mbulesa të reja për krevatet spitalorë, janë ljer të gjitha 24 dhomat e Repartit ku ndodhen lehonat dhe foshnjat, rroba nate për lehonat dhe veshmbathje për foshnjat, mori Klinika universitare për gjinekologji dhe obstetrikë. Bëhet fjalë për donacion të kompanisë boshnjako-hercegovase "Violeta" e cila përmes projektit "Të krijojmë së bashku" dhuroi mjete për këtë klinikë. Në prezantim të donacionit mori pjesë ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili u falënderua për donacionin nga kompania, e cila, siç tha, ka investuar mjete për pajisje Repartit neonatologjik të Klinikës, me qëllim që kushtet e nënave dhe foshnjave prej sot t'u afrohen standardeve evropiane. Drejtoresha e Klinikës, Viktorija Jovanovska u falënderua për donacionin, me të cilin, siç tha, mundësohen kushte më të mira për nënat dhe foshnjat në këtë institucion publik shëndetësor. Shefja e Repartit për kujdes intensiv dhe terapi të foshnjave, doktoresha Elizabeta Petkovska tha se vitin e kaluar ka pasur 36 foshnje të vdekura në 1.000 të lindura të gjalla, ndërsa këtë vit, përfundimisht me shtatorin, ai numër paraqet 24. Ajo tha se 50 për qind e foshnjave të vdekura janë ekstremisht të vogla, të papjekura me peshë nën 1000 gramë dhe nën javën e 28-të të gestacionit. Ambasadorja e BeH-së, Babiq tha se me donacionin është krijuar ambient i bukur në dhomat ku qëndrojnë nënat dhe foshnjat e sapolindura. (D.K)

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 17 tetor - Ministri pa resor për çështje ekonomike dhe investime të huaja i Qeverisë së Maqedonisë, Bardhyl Dauti, ka qëndruar për vizitë në Zonën zhvillimore teknologjike industriale në Tetovë ku nga ana e drejtorit të kësaj zone për së afërmi është njoftuar për mbarëvajtjen e punëve të deritashme në këtë zonë.

Sipas ministrit Dauti, në takim me drejtorin e kësaj Zone është biseduar për investimet potenciale dhe tërheqjen e sa më shumë investitorëve. Drejtuesve të Zonës së

## USAID-i promovon kohezionin ndëretnik

Projekti i USAID-it për Integrimin Ndëretnik të të rinjve në arsim është nismë pesëvjeçare për përforcimin e kohezionit ndëretnik midis të rinjve dhe zhvillimin e sjelljeve demokratike dhe qytetare

Koha

Qefsere ABDYLI

Shkup, 17 tetor - Në organizim të USAID-it, projekti për Integrim Ndëretnik të të rinjve në arsim u shënuar me një ngjarje për të promovuar shembuj dhe praktika të mira për aktivitete të përbashkëta të nxënësve që zbatohen nëpër shkollat në Maqedoni. Qëllimi i aktiviteteve të tilla në të cilat marrin pjesë të rinjtë nga komunitetet e



ndryshme etnike, është përmirësimi i bashkëpunimit dhe integritetit ndëretnik ndërmjet tyre, si dhe përforcimi i vlerave të tyre qytetare dhe demokratike. Krahas nxënësve dhe mësimit, në ngjarje morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve arsimore, organizatave ndërkombëtare, organizatave joqeveritare dhe të tjera. Projekti i USAID-it për Integrimin Ndëretnik

të të rinjve në arsim është nismë pesëvjeçare për përforcimin e kohezionit ndëretnik midis të rinjve dhe zhvillimin e sjelljeve demokratike dhe qytetare. Ky projekt bazohet në arritjet e projektit të USAID-it për integrimin ndëretnik të të rinjve në arsim, i cili në periudhë prej pesë vitesh realizoi bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Maqedonisë dhe të gjitha

shkollat fillore dhe të mesme me ç'rast i ndërtoi 400 partneritete midis shkollave në mbarë vendin, organizoi aktivitete ndërkulturore në të cilat morën pjesë mijëra nxënës dhe rinovoi 63 shkolla. Ky projekt i USAID-it gjithashtu punon në partneritet me të gjitha komunat, shkollat fillore dhe të mesme në Maqedoni me qëllim që të rinjtë të përkatësisë së ndryshme tu

mundësojë të mësojnë për të drejtat e qytetarëve dhe përgjegjësi përmes realizimit të nismave të thjeshta për përmirësimin e shkollave dhe bashkësive të tyre. Shkollat të cilat tregojnë përkushtim të veçantë dhe pjesëmarrje aktive në përforcimin e integritetit ndëretnik dhe vlerave qytetare do të shpërblehen me mbështetje plotësuese për rinovimin e shkollave nga Komanda Evropiane e Armatës së SHBA-së. Profesoresha Maja Velkoviç Dimkovska nga shkolla "Pero Nakov" nga Kumanova tha se në shkollën e tyre është zbatuar aktiviteti "Zbukuroje qytetin", në të cilën morën pjesë shumë nxënës. Ajo thekson që nxënësit e tyre duan që ti rindërtojnë objektet e vjetra dhe të braktitura në Kumanovë. Sipas nxënësve, qytetit i mungon kinemaja, sallat sportive, qendra tregtare e të tjera.



# Ikja



Nga  
Nazim RASHIDI

Por as skandal s' do ketë, se s' do ketë mbetur askush as të skandalizohet. Fundjavën e kaluar isha në Strugën time. Në të gjitha takimet me familjarë e miq, temë diskutimi ishte pa përjashtim e ardhmja e vendit dhe çdo të ndodhë me vendin që sa herë që dukej në këto javë se të ardhmen e ka të qartë, aq më shumë po futet në paqartësi.

"Duhet ikur sa më parë", tha një shok i cili nuk ka jetë të keqe. I sistemuar me punë, të ardhura stabile, me shtëpi të bukur, të gjithë familjarët me angazhime e biznese, bashkëshortja gjithashtu e punësuar. Por, tek pinte birrën mëmërishte se do ikë sa më parë nga ky vend.

Dhe tek bëhej biseda se sa gjërat shkojnë keq, e sa s'mërziten politikanët për këtë vend, e sa pa përgjegjësi ka sidomos tek klasa politike maqedonase të cilët nuk po dinë të kapin momentin historik për vendin, e si po lënë peng breza të tërë, në kafenenë tonë të preferuar ku kamerierët janë aq të njohur, gati-gati, shokët tanë, na shërben një fytyrë e re. Kamerieri i ri, ende nuk dinte huqet e tavolinës dhe si i tillë tërhoqi vëmendje. Pyetëm pronarin, një shok e mik edhe ai dhe na tha se është nga Shqipëria. Ende nuk na nje plotësisht si klientë, e me të qeshur na tha se duhet ta marrim me të mirë.

Asgjë e pazakontë mbase, se Struga pranë Shqipërisë është, por arsyeja e ardhjes të atij djalit ishte se një numër i madh të rinjsh nuk ishin më në Strugë. Ka ndodhur, por edhe ky fenomen viteve të fundit është shfaqur, që kamerierë apo dhe krahë punë të kenë ardhur nga Shqipëria, kryesisht verës, por kësaj here edhe pas sezonit turistik gjatë të cilit kërkohet më shumë angazhime. Në lokalin thuhetse gjysëm bosh, jo tipike për fundjavat e Strugës, pronari i tij tregon se thuhetse s'ka të rinj më në qytet. Kamerierët e tij, që ne i njohim e që na dinë tekat e porosive, kishin ikur jashtë. Shoku im në tavolinë do të ikë, pronari i lokalit do të ikë, të gjithë rreth nesh flasin për ikje.

Ikja ishte fjala e mbrëmjes. Ditën tjetër, për të shfrytëzuar rrezet e diellit dhe vjeshtën plot ngjyra, babi im sugjeroi të shkojmë në mal, në korrje, siç thotë ai, se ishte edhe koha e gështenjave, por edhe për të parë vendin që s'kishim qenë me vite. Rrugës, duke kaluar nëpër fshat, me shtëpi të mëdha, oborre me parqe,

por pa lëvizje, temë e diskutimit ishte ikja. Sërish ikja.

Në një pjesë të fshatit pa mbërrirë buzë malit, më tregonte shtëpitë të cilat ishin bosh, të tjera që sapo ishin boshatisur dhe në një hapësirë me rreth dhjetë shtëpi, kishte vetëm dy fëmijë, djem të rinj, njëri student që praktikisht nuk jetonte aty dhe tjetri gjimnazist.

Po. Të gjithë kishin ikur. Rruga për në mal nuk ishte e pastruar, natyrisht dhe gjethet plot ngjyra e shumë ndjellëse, edhe pse tërheqëse, nuk të linin të shkoje shumë larg. Prapë për të njëjtën arsye, shumë kohë nuk kishin kaluar njerëz andej, e rrugët edhe ishin mbyllur.

Nuk është se as ju nuk e dini faktin se një numër i madh i njerëzve, sidomos të rinj po ikin. Por mendoj se duhet theksuar e ritheksuar këtë fakt sepse duhet mbetur i dokumentuar realiteti, se zbrazja kësaj here ndodh për shkak të zhgënjimit të madh që vjen nga politika kryesisht dhe papunësia. Maqedonia është në një moment tejet delikat në ekzistencën e saj. Dhe me të gjithë që flas e më rrethojnë, si privatisht ashtu dhe profesionalisht, e thonë se nuk mund të humbet rasti për të dhënë shpresë dhe shtysë për të shkuar për-

para.

Por ja që frika dhe rreziku që kjo të ndodhë është e mundur. Doja të shkruaja sot për fenomene të tjera, për lirinë e shprehjes dhe për filmin kontrovers në Maqedoni "Tallja e Krishtit" që ngjalli debate, doja të shkruaja për censurën dhe si ndalimi i një filmi është më keq se një film i keq. Doja të shkruaja për guximin dhe rrëfimin e tmerrshëm të zonjës Vasfije Krasniqi që publikisht foli për përdhunimin e saj nga forcat serbe në Kosovë. Doja të shkruaja për bashkëshortin e saj, vëllezërit e saj, që në fund të rrëfimit emocional e përqafuan dhe e mbështetën.

Doja të shkruaja edhe për një vjetorin e pushtetit lokal. Një vjetor pas zgjedhjeve lokale se si qytetet tona duken edhe më të pa pastra, edhe më kaos, edhe me më shumë probleme. Por sërish për fat të keq, më dominoi përshtypja e marrë nga qytetet dhe fshatrat tona të zbrazura. Ajo ndjesia se mund të flasësh për gjithçka por kot, kur njerëzit më s' do jenë këtu.

Kjo ndjesi më përforcohet edhe më shumë, sepse edhe ata që duhet të punojnë për të mbajtur njerëzit nuk besojnë më në këtë vend. Pas një debati të fortë televiziv, një për-

**Kjo është pamja sot. Ata që duhet të punojnë për të ardhmen e frenojnë atë. Ata që duhet të punojnë për njerëzit i shfrytëzojnë ata. Ata që duhet të japin shpresë e vdesin atë. Dhe për fat të keq në kulmin e krizës politike, e vetmja zgjidhje i bie të jetë ikja. Prandaj dhe jo rastësisht dominon si opsion. E kur të gjithë të kenë ikur, s' do ketë më rëndësi asgjë. As marrëveshja, as e emri i shtetit e as ata pak që do kenë mbetur. Skandali do jetë, se ata që do jenë, apo dhe që janë fajtorë për ikjet në fakt do ikin të parët**



faqësues i lartë i një partie më tha, "se kuptoj se pse je kthyer prej Londre, çfarë po bën këtu. S'të kuptoj?". Ia ktheva, duke i thënë, "po ti e thua këtë. Ti që duhet të japësh shpresë. Që duhet të krijosh kushte e të nxisësh të tjerët të kthehen?". Siç ndodh më kohëve të fundit, ku pesha e fjalës së thënë në publik, ka devaluuar rëndë, politikani i zellshëm për tu zënë se marrëveshja me Greqinë ishte e keqe, tha me lehtësi të madhe se "bënte vetëm shaka".

Por kjo është pamja sot. Ata që duhet të punojnë për të ardhmen e frenojnë atë. Ata që duhet të punojnë për njerëzit i shfrytëzojnë ata. Ata që duhet të japin shpresë e vdesin atë. Dhe për fat të keq në kulmin e krizës politike, e vetmja zgjidhje i bie të jetë ikja. Prandaj dhe jo rastësisht dominon si opsion. E kur të gjithë të kenë ikur, s' do ketë më rëndësi asgjë. As marrëveshja, as e emri i shtetit e as ata pak që do kenë mbetur. Skandali do jetë, se ata që do jenë, apo dhe që janë fajtorë për ikjet në fakt do ikin të parët.

Por as skandal s' do ketë, se s' do ketë mbetur askush as të skandalizohet.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovaska lok.14 - përdhese, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 17 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



Nr. 10-10350/2 dt. 02.10.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18, 168/18) dhe Vendim me nr. 10-10350/1 dt. 02.10.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

## KOMUNIKATË

**për organizimin e Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 Tetovë**

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, komuna e Tetovës** me nr.teknik 11-3/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë, Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Video Smilevski Bato", rr."Video Smilevski Bato 1", rr."Video Smilevski Bato 2", dhe rr."Vëllezërit Miladinov".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 4.43 ha.

Brenda përfshirjes planore të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, A2 - banim në ndërtesa kolektive, D1 - Park për gjelbërim, E2 - Suprastrukturë komunale, E1 - Infrastrukturë komunale.

**ANKETA PUBLIKE** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74, komuna e Tetovës, do të zgjas 10 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 25.10.2018 – 07.11.2018 vjet.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK** sipas Propozim të ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74 KK Tetovë 2, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 26.10.2018 në ora 12:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për pjesë të Bllokut Urban 74, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi

Nr. 10-177/21dt. 01.10.2018

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16, 163/16, 64/18, 168/18) dhe Vendim me nr. 10-177/20 dt. 01.10.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

## KOMUNIKATË

**për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike - Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63**

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e Përsëritur të **Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63 KK Tetovë 1, me nr. tek. 2-4/17 i përpunuar nga "URBANPLAN" – SHPK Tetovë**. Periudha planore 2017-2022.

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Bllagoja Toska", rr. "Mehmet Pash Deralla (29 Nëntori)", rr. "Dervish Cara" dhe rr. "Dimo Gavrovski Kara".

Përfshirja është me sipërfaqe prej 2.23 ha.

Brenda përfshirjes planore të Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në shtëpi banesore, A2 - banim në shtëpi kolektive, E1 - Infrastrukturë komunale.

**ANKETA PUBLIKEE PËRSËRITUR** - Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, komuna e Tetovës, do të zgjatë 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 25.10.2018 – 31.10.2018 vjet. Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

**PREZANTIMI PUBLIK I PËRSËRITUR**- Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 26.10.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Propozim ndryshimit dhe plotësimit të Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 63, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,  
Teuta Arifi

### "Shpallje publike për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Sekretariatit për legjislacion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë"

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18), shpallja përfshinë punësim të 1 (një) personi për kohë të caktuar për periudhë deri më 31.12.2018 i cili do të punojë në Sekretariatit për legjislacion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë edhe atë në vendin e punës **Bashkëpunëtor – asistent për mbështetje teknike-operative të Sekretariatit**.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim të nevojshme për kryerje të detyrave:

1. Lloji i arsimit: së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga sfera e shkencave ekonomike, shkencave juridike ose administratë publike;
2. Përvojë pune: së paku 1 vjet përvojë pune në profesion;
3. Kualitetet personale: njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane).
4. Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, gjegjësisht më së voni deri më 26.10.2018, deri në ora 16:30, ndërsa zgjedhja e kandidatëve do të realizohet më së voni deri më 31.10.2018.

Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë pune (08:30 – 16:30), ndërsa neto pagesa bazë është 22.501,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen krahas biografisë së shkurtë, kandidatët janë të obliguar që të parashtrijnë edhe dëshmi përkatëse në origjinal ose kopje, në pikëpamje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme edhe atë:

- Diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Vërtetim për përvojën e punës që kërkohet për vendin e punës;
- Certifikatë për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- Certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze, frënge ose gjermane;
- Shtetësi;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Dokumentet e kërkuara parashtrihen me zarf të mbyllur me shenjë "Të mos hapet" në adresën në vijim: Sekretariati për legjislacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr 54, Shkup (me shenjë "Për shpallje").

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit. Kandidatët me dokumentacion të rregullt dhe të cilët i përmbushin kushtet e theksuara do të ftohen në intervistë në Sekretariatit për legjislacion.

Sekretariati për legjislacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,  
Kontakt telefoni 02/3228-203

Në bazë të nenit 160 paragrafi (3) i Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 82/18), ndërsa në lidhje me nenin 6 dhe nenin 20g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), dhe nenit 22 paragrafi (1) alineja 1 të Ligjit për marrëdhënie pune, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/2016 dhe 120/18), Fakulteti për shkenca bujqësore dhe ushqim – Shkup, në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, publikon

### **SHPALLJE PUBLIKE Për punësim**

#### **1. BASHKËPUNËTOR I RI PËR RESURSE NJERËZORE 1 realizues**

Kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:

-niveli i kualifikimeve VIV sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të sferës së shkencave bioteknike, shkencave juridike ose shkencave humane (cilësdo fushë).

-me ose pa përvojë pune në profesion.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 20.282,00 denarë. Pagesa mund të jetë e ndryshueshme.

#### **2. BASHKËPUNËTOR I RI PËR ÇËSHTJE STUDENTORE 1 realizues**

Kandidatët për këtë vend pune duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:

-niveli i kualifikimeve VIV sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar të sferës së shkencave bioteknike ose shkencave humane (cilësdo fushë).

- me ose pa përvojë pune në profesion.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 20.282,00 denarë. Pagesa mund të jetë e ndryshueshme.

Kandidatët me fletëparaqitjen duhet të parashtrijnë dëshmitë për përmbushje të kushteve, në formën origjinale ose kopje të vërtetuar në noter:

- 1 Dëshmi të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
2. Dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës Certifikatë të mjekut;
3. Dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
4. Biografi të shkurtë
5. Diplomë për arsim të mbaruar sipëror ose certifikatë për provime të dhëna

Orari i kohës së punës: orët e punës në javë: 40, orari i punës prej ora 08:00 deri në ora 16:00, ditët e punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte.

Me kandidatin e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 3 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme duhet të parashtrihen në zarf të mbyllur në lokalet e Fakultetit të shkencave bujqësore dhe ushqimit – Shkup, në rr. 16 Makedonska Brigada nr. 3, me shenjë "Për shpallje për punësim në Fakultet, për vendin e punës me numër rendor.

Nëse një kandidat dëshiron të aplikojë për më shumë vende pune, duhet që për secilin vend pune të parashtrijë kopje të dokumenteve.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.



# RASTI MOTASSADEQ. LIROHET NDIHMËSI I ATENTATORËVE TË 9/11

Ditë shtatori me erë në Hamburg. Trafiku zhvillohet normalisht në Steindamm, një rrugë e gjerë jo larg stacionit hekurudhor, ku parakalojnë edhe shumë turistë. Tek numri 103 gjendet një dyqan i automjeteve. Dikur ka qenë këtu xhamia Al-Quds, ku faleshin edhe anëtarët e grupit terrorist, atentatorët e sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001. Simpatizantët e atentatorëve e kanë vizituar më pas këtë xhami, ku janë gjuhëzuar ashtu si edhe piloti vetëvrasës Mohammed Atta. Ai u turr me avion më 11 shtator në njëren nga kullat binjake të World Trade Centers në Nju Jork.

Në numrin 103 nuk falet sot askush më, por këtu gatuhet - këtu është një restorant vietnamez. Xhamia Al-Quds u mbyll përfundimisht në vitin 2010. Pikëtakimi i islamistëve radikalë ishte shndërruar në një halë në sy për autoritetet, të cilët e mbyllën atë.

## NË SANTA FU

Edhe marokeni Mounir El Motassadeq është falur në xhaminë Al-Quds. Në fund të vitit 2001 ai u arrestua, nën akuzat për ndihmën e terroristëve dhe u dënua me 15 vjet heqje lirie. Dënimin e ka vuajtur në "Santa Fu", siç e quajnë këtë burg në Hamburg. Ai ka pasur sjellje korrekte, ka qenë i sjellshëm dhe miqësor. Një tip i qetë, thonë ata që e kanë parë. Në burg ai përfundoi studimet në elektroteknikë. Kjo ishte edhe arsyeja e ardhjes së tij në Hamburg në vitet 90-të, në Universitetin Teknik. Një universitet i mirë që me krah të hapur ka pritur shumë studentë të huaj.

## GRUPI TERRORIST I HAMBURGUT

Atje Motassadeq u njoh me egjiptianin Mohammed El Amir, të njohur si Mohammed Atta, një nga personat kryesorë në sulmet terroriste të 11 shtatorit. Motassadeq ka qenë mik me Atta dhe e ka nënshkruar testamentin e tij. Në Hamburg-Harburg ka studiuar edhe Marwan Al-Shehhi, i cili fluturoi me avion në kullën binjake jugore të World Trade Center. Më pas ky grup u bë i njohur si "celula e Hamburgut", ku bënte pjesë edhe piloti vetëvrasës Ziad Jarrah si dhe Ramzi Binalshibh, i cili gjendet në burgun e Guantánamos.

Këta të rinj u radikalizuan së bashku. Në kampet e Al Kaidës në Afganistan ata mësuuan të përdorin armët. Motassadeq ka qenë në Afganistan në maj të vitit 2000. Kryesia e Al-Kaidës, e afërt me Osama Bin Ladenin, kishte përzgjedhur disa nga studentët e gatshëm për sulme



• Goditja me avion e kullave binjake në Nju Jork më 11.09.2001



• Ekstradimi i Mounir El Motassadeq për në Marok, Hamburg më 15.10.2018



• Ish-xhamia Al-Quds, ku faleshin anëtarët e celulës në Hamburg

terroriste. Motassadeq nuk ishte në mesin e tyre, ai vepronte në sfond. Në nëntor të vitit 2001 u arrestua dhe më pas u akuzua për anëtarësi dhe ndihmën e grupit terrorist në vrasjen e më shumë se 3000 personave, sa gjetën vdekjen në Nju Jork dhe Uashington. Një avion ishte rrë-

zuar në Pennsylvania, pasi pasagjerët ishin përpjekur të rimarrin nën kontroll avionin.

Gjykatësit ishin të bindur se Motassadeq ka pasur dijeni për këto plane të mëdha për sulmet terroriste. Por ai nuk e ka ditur se cilat janë caqet e sulmeve, sepse për këtë ishin

informuar vetëm pak njerëz. Por ai u dënua edhe për ndihmën e atentatorëve gjatë stërvitjeve.

## PROCESI SHUMËVJEÇAR

Procesi kundër Motassadeq ka zgjuar interesim të madh dhe ishte shumë i komplikuar. Avokatët e tij

Gjurmët e sulmeve terroriste të 11 shtatorit në SHBA mbërrijnë deri në Hamburg të Gjermanisë. Mounir El Motassadeq, anëtar i rrjetit terrorist ka qenë 15 vjet në burg. Tani marokeni u lirua nga burgun.



• Motassadeq para godinës së përmbarrimit në Hamburg

pohonin se ai është i pafajshëm, ndërsa prokuroria e fajësonte për ndihmën e terroristëve. Një nga avokatët e tij edhe sot është i bindur se ai është i pafajshëm. Gazetarët që e kanë ndjekur këtë proces thonë se dëshmitë kanë qenë të dobëta. Në prill të vitit 2004 Motassadeq madje u lirua përkohësisht nga burgun. Në mbarë botën u përhapën fotografi me buzëqeshjen e tij duke dalë nga burgun. Qeveria amerikane ishte e indinjuar: Motassadeq është një "tip i rrezikshëm", kumtoi një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme amerikane.

## "JAM I PAFAJSHËM"

Motassadeq nuk e ka mohuar kurrë se ka qenë mik me atentatorët dhe se është kujdesur për ta. Por ai thotë se nuk ka ditur kurrë për planin e tyre për sulme. Ai nuk është përgjigjur në kërkesën e DW për intervistë, por ka biseduar me gazetarët në vitin 2009. Gazetarit irlandez Anthony Summers ai i ka dhënë në burg një intervistë të gjatë, të cilën e ka parë edhe DW. "Të bësh përgjegjës një person të pafajshëm, nuk e ndihmon askënd - as ata që kanë vdekur, as familjet e tyre dhe as të vërtetën", thoshte Motassadeq, në





• Pjestarët e celulës së Hamburgut

intervistën e vetme që është publikuar deri tani.

Summers është autor i librit "The Eleventh Day: The Full Story of 9/11", të cilin e ka shkruar së bashku me Robbyn Swan. Ky libër në vitin 2012 ka fituar çmimin Pulitzer. Në kuadër të hulumtimeve për librin, Summers ka biseduar me Motassadequn shumë orë në burg. Ai thotë, se ai ka qenë i shokuar nga këto sulme. Dy ose tri ditë më vonë i ka parë fotografitë e miqve të tij në TV: "Shoku ishte edhe më i madh ku i pashë".

**15 VITE BURG**

Por procesi zgjati me vite të tëra. Në janar të vitit 2007, ai u dënua me 15 vjet heqje lirie. Ai u shpall fajtor për bashkëveprim në një grup terrorist dhe ndihmë në vrasjen e 246 personave. Gjykatësit vendosën që pas vuajtjes së dënimit, Motassadeq duhet të largohet nga Gjermania në Marok. Ai nuk mund ta shkelë tokën gjermane para vitit 2064.

Motassadeq është falur pesë herë në ditë gjatë kohës sa ka vuajtur dënimin në burg. Ai është rritur së bashku me pesë vëllezër dhe motra në qytetin Marrakesh. "Pa këto falje, një person si unë, do të kryente vetëvrasje", thotë ai në bisedë me Summers. Ai gëzonte një respekt të madh në skenën ekstremiste-salafiste. Por ai vet nuk ishte i interesuar për kontakte me këtë skenë, thonë autoritetet e sigurisë. Një i njohur i tij nga Boni thotë se "besimi i Motassadeqit është aq i fuqishëm, sa që ai mendon se të gjitha që ndodhin janë vullneti i Zotit". Të njohurit dhe autoritetet e sigurisë e konsiderojnë atë si një të ri të sjellshëm dhe të qetë. "Por autoritetet janë të mendimit se ai nuk i ka ndryshuar bindjet

e tij", thotë një punëtor i sigurisë për Deutsche Welle.

**NUK KA LIRIM TË PARAKOHSHËM**

Ky vlerësim i autoriteteve ka bërë që të refuzohet kërkesa e Motassadequt për lirim ta parakohshëm nga burgu. Gjykatësit ishin të mendimit se ai nuk ka hequr dorë nga bindjet e tij "islamiste dhe xhihadiste". Ai nuk ka hequr dorë as nga bindjet e tij për stërvitje ushtarake, sepse mendon se secili duhet të kryejë obligimin ushtarak. Edhe Daniel Zerbin, profesori për shkencat e kriminologjisë mendon se Motassadeq nuk i ka ndryshuar bindjet. Zerbin është marrë shumë me celulën e Hamburgut në temën e tij të doktoraturës.

Autoritetet kanë bërë të ditur se Motassadeq do të arrestohet menjëherë nëse e shkel sërish tokën e Gjermanisë. Por duket se ai nuk e ka ndërmend të kthehet. Në Marok pret gruaja e Motassadequt, një ruse e konvertuar në fenë islame, si dhe tre fëmijë të moshës 11 deri 18 vjeç. Ata janë të bindur se Mouniri ka qenë i pafajshëm në burg.

**MBIKËQYRJA**

Motassadeq me siguri që nuk do të kthehet shumë shpejt në jetën normale në Marok. Forcat e sigurisë në këtë vend janë duke ndërmarrë të gjitha masat që të mos përsëriten sulme terroriste. Vëzhguesit janë të bindur se Motassadeq do të merret në pyetje pas kthimit në vend, e madje ndoshta edhe do të arrestohet dhe do të nxirret para gjykatave. Por është e sigurt se ai do të jetë nën mbikëqyrje. Amerikanët janë të interesuar të dinë nëse Motassadeq ende paraqet rrezik për sulme.

**HERO I AL KAIIDËS**

A ka vërtet ndonjë rrezik nga Mounir El Motassadeq, 17 vjet pas sulmeve terroriste në SHBA? Kjo nuk i intereson më thaujse askujt, thonë autoritetet gjermane. Në moshën 44 vjeç ai nuk është më i përshtatshëm për të qenë një simbol i islamistëve. Por punonjësi i shërbimeve sekrete Phil Gurski mendon ndryshe. Ai mendon se rrjeti terrorist Al Kaida edhe më tej e konsideron Motassadeq hero, sepse ai ka luajtur një rol në sulmet më të mëdha terroriste deri më sot dhe nuk e ka tradhtuar askënd nga rrjeti. Edhe Daniel Zerbin mendon se ai mund të përdoret si figurë për propagandë: Motassadequ me siguri që nuk do të bëjë bomba me dorë. Por ai do të trajtohet si një "simbol", e simbolet e tilla janë figura të rëndësishme të terrorizmit.



**ZHDUKJA E GAZETARIT ARAB**



**LOJËRA TAKTIKE NGA TË GJITHA ANËT**

Në rastin e gazetarit të zhdukur arab, Xhamal Khashoggi duket se gjërat po lëvizin. Sekretari i Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo zhvilloi bisedime me palën arabe. Ndërkohë turqit kontrolluan banesën e konsullit arab



të martën ata zhvilluan kontrolle edhe në rezidencën e konsullit të Arabisë Saudite në Stamboll për të kërkuar për gjurmë të gazetarit të zhdukur.

Ndërkohë mediat turke njoftojnë se konsulli saudit u largua me avion për në Arabinë Saudite. Me gjasë Turqia ka në dorë edhe një kartë që nuk e ka luajtur akoma me Trump. Turqia duket se ka filmime dhe regjistrime të torturimit dhe vrasjes së Khashogis, që janë bërë me orën Smart të gazetarit lidhur me një smartphone.

Për Arabinë Saudite ka interres të ruajë fytyrën në sqarimin e zhdukjes së Khashogis. Flitet se një deklaratë e mundshme do të jetë që Arabia Saudite të pranojë që Khashoggi ishte në konsullatë, dhe është marrë në pyetje, ku situata ka dalë jashtë kontrollit. Me rëndësi duket të jetë mosvendosja e asnjë lidhjeje me

shhtëpinë mbretërore saudite. Nëse Pompeo u tregua më i ashpër në bisedimet e brendshme se para medias, kjo mbetet të shihet në ditët e ardhshme.

Ndërkohë, Konsulli Gjeneral i Arabisë Saudite në Stamboll, Mohammad al-Otaibi, është larguar nga Turqia për të shkuar në vendin e tij. Sipas të dhënave të siguruar nga zyrtarët, Otaibi është nisur për në Arabinë Saudite në orën 17:00 sipas kohës lokale. Në rezidencën e konsullit saudit në Stamboll është paraparë të kryhet një hetim në lidhje me rastin e gazetarit të zhdukur Jamal Khashoggi. Gazetari dhe kolumnisti i "The Washington Post", Jamal Khashoggi, i cili ka dhënë kontribute edhe për "Al Watan", një platformë e rëndësishme për reformistët sauditë, u zhduk më 2 tetor pasi hyri në kompleksin e Konsullatës së Arabisë Saudite në Stamboll.



Për këtë arsye Trump dërgoi edhe Sekretarin e Departamentit të Shtetit në Riad, Mike Pompeo, i cili u takua me Mbretin Saudit, Salman dhe princin trashëgimtar, Mohamed bin Salman. Pompeo përdori dukshëm tonte të buta në drejtim të Riadit. Nuk u dëgjua asnjë fajësim i regjimit saudit për zhdukjen e gazetarit. Zëdhënësjja e Pompeo tha pas takimit, se edhe pala saudite e sheh nevojën e "një hetimi të thellë dhe transparent."

Por hetimet janë kryesisht në dorën e Turqisë, pasi gazetari u zhduk pas hyrjes në konsullatën arabe në Stamboll. Hetuesit turq kontrolluan konsullatën arabe,



Dy beteja diplomatike dhe politike po zhvillohen aktualisht ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. E para, ndërlidhet me përpjekjet e Kosovës për anëtarësim në INTERPOL dhe kundërshtimet e vazhdueshme të Serbisë. Kurse e dyta, ndërlidhet me transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës [FSK], duke e veshur atë me kompetenca e kapacitete shtesë që u ofrohen përgjegjësive të forcave të armatosura, për të cilën po ashtu nuk pajtohet Beogradi

Kur është në pyetje FSK-ja, kundërshtimi vjen edhe nga brenda, përmes Listës Serbe, e cila po ashtu mbështetet nga Beogradi zyrtar. Zëvendëskryeministri i parë, njëherësh Ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli tha për Radion Evropa e Lirë, se Kosova shumë shpejt do të jetë anëtare e INTERPOL-it. Megjithatë ai pranon se pengesat në këtë drejtim nga Serbia janë evidente.

"Sfida për INTERPOL do të jetë edhe më e madhe. Ata veç e kanë filluar luftën e tyre. Janë duke punuar, kanë delegacione nëpër botë, kanë paguar lobistë të cilët llojnë kundër Kosovës.

"Ne jemi në posedim të letrave

# INTERPOL-i DHE FSK-ja, DY BETEJAT DIPLOMATIKE TË KOSOVËS ME SERBINË



të cilat ata i shkruajnë dhe iu rekomandojnë shteteve që mos ta mbështesin Kosovën. Këtu, bile duke shkruar edhe gjëra që nuk qendrojnë. Neve na mbetet të ecim përpara, gjithmonë krenar, gjithmonë kryelartë, jo të ju tregojmë gjëra pa fakte ose gënjeshtër", tha Pacolli.

Ai tha se institucionet e Kosovës janë duke punuar intensivisht në drejtim të anëtarësimit në INTERPOL.

Nga ana tjetër, Vjosa Osmani, deputete dhe kryetare e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike nga Lidhja Demokratike e Kosovës, konsideron se drejtuesit e institucioneve nuk duhet të nguten dhe të japin

deklarata dhe të thonë se çështja e anëtarësimit të Kosovës në INTERPOL është punë e kryer, pasi që sipas saj, punë e kryer do të jetë vetëm në ditën kur votohet pro Kosovës. "Natyrshik sikur të ishte anëtare e përgjegjshme e komunitetit ndërkombëtar Serbia nuk do ta bllokonte Kosovën në asnjë organizatë mirëpo fatkeqësisht është treguar destabilizuese", tha deputetja Osmani.

Në anën tjetër, shefi i diplomacisë së Kosovës, Behgjet Pacolli thotë se është e vërtetë se Kosova ka pengesa edhe përbrenda institucioneve, përmes Listës Serbe.

Pengesat, vijin në shprehje sidomos në aspektet e fuqizimit të shtetësisë së Kosovës, ngase kjo li-

stë, pavarësisht që merr pjesë në institucionet e Kosovës, i bindet Beogradit.

"Po është e njëjta. Një luftë që zhvillohet jashtë [Kosovës], ajo zhvillohet tash edhe në Kuvendin e Kosovës. Mua kjo më shqetëson pak, sepse kjo e bën Kosovën një shtet jofunksional dhe këtë të keq duhet ta luftojmë. Për këtë arsye unë gjithmonë flas dhe bëj thirrje për unitet të qarqeve politike kosovare", tha Pacolli.

Kurse, deputetja Vjosa Osmani ka hedhur kritika edhe në drejtim të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili sipas saj, me deklaratat e tij po shpreh skepticizëm, sidomos për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL.

"Në vend të deklaratave këtu duhet punë, presidenti do të duhej që tani të udhëtonte nga një vend të tjetri e jo ta bëjë të kundërtën duke shprehur skepticizëm për një gjë të tillë", tha ajo.

Sa i takon bllokimit të deritani-shëm të formimit të ushtrisë së Kosovës nga ana e deputetëve të Listës Serbe, deputetja Osmani thotë se pretendimet e tyre tashmë nuk do të kenë vend askund, dhe se Kosova do ta ketë ushtrinë e saj.

"Nuk mund ta pengojë Lista Serbe sepse janë 110 deputetë të tjerë që janë pro. Dhe gjatë procesit të miratimit të këtyre ligjeve që fillon të enjten ata nuk e kanë të drejtën e vetos dhe rrjedhimisht nuk kanë mundësi që të ndërmarin asnjë veprim më", tha Osmani.

Sidoqoftë, transformimi i FSK-së pa ia ndërruar emrin në armatë apo ushtri me disa kompetenca shtesë dhe kapacitete më të plota, ishte pikërisht rezultat i kundërshtimeve të Listës Serbe, pa votat e të cilës nuk mund të bëhen ndryshimet kushtetuese të domosdoshme për formimin e ushtrisë.

Ndërkaq, për anëtarësimin e Kosovës në INTERPOL do të dihet në fund të nëntorit, me gjasë më datën 20 nëntor, kur do të mbahet Asambleja e Përgjithshme e kësaj organizate ndërkombëtare policore në Emiratet e Bashkuara Arabe.

## BEOGRADI REAGON PËR 'TELEKOM SERBIA' Të habitur me deklaratat e Kryeministrit Rama

Telekomi serb ka ende shpresa se do të gjejë ende treg në Shqipëri. Oferta e tyre nuk ka marrë përgjigje zyrtare pavarësisht kundërshtive dhe deklarimit të vet Kryeministrit, Edi Rama.

Rasim Lajç, ministër i Telekomunikacionit në Serbi, thotë se blerja e Telekomit shqiptar nuk është asnjë lloj kërcënimi apo brenge për sigurinë e askujt.

"Ende nuk e dimë epilogun përveç deklaratës së Ramës që është për t'u habitur pasi në këtë epokë të tregtisë së lirë prej kohësh nuk kam dëgjuar që nga një pozitë e tillë, në këtë mënyrë, të eliminohet një blerës potencial. Nuk mund të shkohet me argumente politike kundër, por në bazë të ofertës dhe besoj se vetëm në këtë mënyrë mund të refuzohet".

Interesi është për treg të përbashkët, thotë ministri serb, sipas të cilit kjo nuk tregohet me mbrojtje apo refuzime. "Ne apelojmë që faktorët ekonomikë dhe oferta konkrete të vendos për këtë dhe jo



faktorët politik. Kjo çështje është e komplikuar pasi telekomi shqiptar nuk është pronë e qeverisë por e Deutsche Telekom që e shet këtë kompani. Nuk shoh arsye që kjo të ndalohet, përveç arsyeve politike, por kjo nuk është mirë për rajonin pasi edhe BE insiston në një treg të përbashkët në kuadër të procesit të Berlinit". Kompanitë serbe janë të interesuar për të ndërtuar hotele në bregdetin shqiptar dhe biznese të tjera që mund të rrisin shkëmbimin tregtar. Telekomit serb ka bërë ofertën e saj dhe ende pret përgjigje. Ministri thotë se partneriteti dhe jo armiqësia është mundësia e vetme.

## Vuçiq: Po dëgjoj marrëzi për Preshevën dhe Bujanocin

"Unë qartazi dyshoj, e shoh se nuk ka asgjë prej kësaj pune, shqiptarët në vend se të reduktojnë pritjet e popullit të tyre ata i rrisin ato, krejt e kundërta se si veprojnë këtu në Beograd dhe Serbi" deklaroi presidenti serb.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq ka thënë në një prononcim për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë, se mendon që është e nevojshme të ngriten kufijtë mes shqiptarëve dhe serbëve.

"Termi përkufizim i kufirit do të thotë që kemi kufij mes shqiptarëve dhe serbëve e që sot nuk e dimë ku janë. Pyetja ime është ku janë ata kufij, aty ku themi ne apo aty ku thonë shqiptarët? Askush në botë nuk e di saktë ku janë këta kufij", ka thënë Vuçiq. Ai i ka bërë këto deklaratat teksa ka folur për detajet e politikës së tij karshi çështjes së Kosovës, në takimin Kina dhe partnerët "16+1" që po mbahet në Beograd.

"Unë kam menduar se është e rëndësishme që të dimë të ardhmen tonë, të kemi paqe dhe stabilitet me shqiptarët në 100 apo 200 vjetët e ardhshme. Qytetarët e Serbisë mendojnë se është më mirë të

jemi as në tokë as në qiell. Mirëpo unë mendoj se kjo është gabim, nuk është pikëpamje e gjerë dhe strategjike por mua më takon të respektoj vullnetin e popullit" ka shtuar Vuçiq. Përveç tjerash, presidenti serb ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se më 11 nëntor do të takojë në Paris, presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi ku do të vazhdojnë diskutimet për çështjen e Kosovës. "Në tavolinë është e lejuar të vihet gjithçka prandaj unë po hesht. Kur dëgjoj marrëzi për, nuk e di, Medvegjen, Bujanocin dhe ku e di se çka, unë nuk bëj zë. Le të thonë gjithçka që mendojnë, dhe do ta shohim a mundemi të mbërrijmë deri te një marrëveshje apo jo. Unë qartazi dyshoj, e shoh se nuk ka asgjë prej kësaj pune, shqiptarët në vend se të reduktojnë pritjet e popullit të tyre ata i rrisin ato, krejt e kundërta se si veprojnë këtu në Beograd dhe Serbi"



deklaroi presidenti serb.

Në këtë deklaratë, Vuçiq ka folur edhe për rolin e faktorit ndërkombëtar në çështjen e Kosovës. "Kemi një qëndrim hipokrit të bashkësisë ndërkombëtare në të cilin nuk kanë rënë amerikanët. Ky qëndrim thotë se gjoja ndryshimi i kufijve, të cilët nuk e dinë ku janë por mendojnë për kufijtë e Kosovës së pavarur, hap kutinë e Pandorës. Po pse atëherë e keni hapur në vitin 2008, në vitin 2006 apo në vitet e 90'ta duke e shkatërruar Jugosllavinë? Çfarë keni bërë kështu?" ka shtruar pyetjen presidenti Vuçiq. Çështja e ndryshimit të kufijve mes Kosovës dhe Serbisë është përmendur disa herë nga presidenti i Kosovës Hashim Thaçi.

Presidenti Thaçi ka përmendur termin korigjim të kufirit, dhe sipas tij, përmes këtij procesi Kosovës do t'i bashkohen komunat e Luginës së Preshevës.





## Izraeli bombardon Gazën në përgjigje sulmeve raketore

Avionët luftarakë izraelitë goditën objektivat në Rripin e Gazës në orët e para të mëngjesit të së mërkurës pasi një raketë u hodh dhe goditi një shtëpi në Izraelin jugor. Banorët në Gaza thanë se aeroplani kishte në shënjestër tre vende, por nuk ka raportime deri tani për viktima. Forcat e Mbrojtjes të Izraelit thanë se sulmi erdhi pasi gjatë natës, një raketë nga territori palestinez goditi Be'er Sheva, zona metropolitane e katërt më e populluar e Izraelit

"Avionët izraelitë filluan të sulmonin objektivat terroriste në rripin e Gazës,"-tha ushtria disa orë pas sulmit. Katër izraelitë po trajtohen në spital për trauma pasi i mbijetuan sulmit të raketave. Raketa goditi pranë një shtëpie të banuar, raportojnë mediat izraelite. Policia izraelite tha se raketa "shkaktoi dëme", pa specifikuar shtrirjen e saj.

# ZHDUKJA E GAZETARIT NË STAMBOLL, POMPEO TAKON ERDOGAN-in

Një zyrtar i lartë i policisë turke tha për Associated Press, se policia gjeti "prova të caktuara" se gazetari saudit Jamal Kashoggi u vra në një konsullatë saudite në Stamboll

Presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan takoi Sekretarin Amerikan të Shtetit, Mike Pompeo. Takimi, i cili zgjati 35 minuta, u zhvillua në aeroportin "Esenboga" të Ankarasë, pak para se presidenti Erdogan të niset për vizitë zyrtare në Moldavi.

Gjatë qëndrimit të tij në Turqi, Pompeo pritet të zhvillojë takim edhe me homologun turk Çavusoglu. Pompeo përsëriti shqetësimet e SHBA-ve në lidhje me zhdukjen e gazetarit saudit dhe vuri në dukje rëndësinë e procesit të hetimit.

"Do të vazhdojmë kontaktin e afërm me zyrtarët turq dhe sauditë, deri sa të kryhet hetimi dhe të njoftojnë rreth gjetjeve", tha Pompeo, duke treguar se presidenti amerikan Donald Trump ka kërkuar nga ai që të vizitojë Tur-



qinë.

Vizita e Sekretarit amerikan të Shtetit vjen pasi ai të martën vizitoi Arabinë Saudite në lidhje me zhdukjen e gazetarit të "Washington Post", Khashoggi. Ai u takua me mbretin saudit Selman bin Abdulaziz, Princin e Kurorës Muhammed bin Selman dhe ministrin e Jashtëm Adel al-Jubeir.

Gazetari i "The Washington Post", Jamal Khashoggi u zhduk më 2 tetor pasi hyri në kompleksin e Konsullatës së Arabisë Saudite në Stamboll.

Ende ka shumë pyetje të hapura lidhur me zhdukjen e gazetarit. Ndërkohë në këtë çështje ka ndërhyrë tani edhe SHBA. Presi-

denti Trump që qëndroi i tërhequr, me sa duket ka kuptuar, se bëhet fjalë për njërin nga partnerët më të rëndësishëm në Lindjen e Afërt. Nëse bëhet publike, se qeveria saudite e ka dhënë porosinë për vrasjen e gazetarit, do të jetë e vështirë për Trump të mbështesë privilegjet e deritanishme për regjimin mbretëror saudit.

Por hetimet janë kryesisht në dorën e Turqisë, pasi gazetari u zhduk pas hyrjes në konsullatën arabe në Stamboll. Hetuesit turq kontrolluan konsullatën arabe, të martën ata zhvilluan kontrolle edhe në rezidencën e konsullit të Arabisë Saudite në Stamboll për të kërkuar për gjurmë të gazetarit

të zhdukur.

Ndërkohë mediat turke njoftojnë se konsulli saudit u largua me avion për në Arabinë Saudite. Me gjasë Turqia ka në dorë edhe një kartë që nuk e ka luajtur akoma me Trump. Turqia duket se ka filmime dhe regjistrime të torturimit dhe vrasjes së Khashogis, që janë bërë me orën Smart të gazetarit lidhur me një smartphone.

Një zyrtar i lartë i policisë turke tha për Associated Press, se policia gjeti "prova të caktuara" se gazetari saudit Jamal Kashoggi u vra në një konsullatë saudite në Stamboll.

Zyrtari, i cili donte të mbetet anonim, nuk dha detaje të provave të gjetura gjatë një kërkimi afatgjatë nga konsullata, e cila zgjati deri në fillim të mëngjesit, të kryer nga hetuesit turq me homologët sauditë.

Zyrtarët turq thonë se agjentët sauditë kanë vranë dhe shkatërruar trupin e Kashogji në Konsullatën Saudite më 2 tetor.

Arabia Saudite deri më tani ka mohuar pretendime të tilla, por media amerikane njoftoi dje se Riadi ka shumë gjasa të pranojë se Kashogji u vra në konsullatë.

Mediat amerikane shkruajnë se Kashogji u vra gjatë marrjes në pyetje.

## Arsim i detyrueshëm në moshën 3-vjeçare

Fëmijët në Francë do ta nisin shkollën nga moshja 3-vjeçare. Projekt-ligji i ri i dërguar në parlament nga ministri francez i arsimit Jean-Michel Blanquer përcakton nisjen e mësimdhënies së detyrueshme në kopshtet publike dhe private. Jean-Michel Blanquer, ministër francez i Arsimit: Është një masë emblematike që do të hyjë në fuqi që prej vitit shkollor 2019 që është shkolla e detyrueshme për fëmijët që në moshën 3



vjeçare. Mësimdhënia e detyrueshme është një vendim historik nga ana e presidentit. Arsimi i detyrueshëm në moshën 3 vjeçare,

është një premtim i presidentit Emmanuel Macron. Për shefin e Elizesë, fëmijët në atë moshë nxënë më shumë dhe në mënyrë më të shpejtë. Megjithatë nisma ka hasur kundërshti, për vështirësitë në zbatimin e saj dhe për kostot ekonomike. Ky vendim vjen pak muaj pas atij për të ndaluar celularët dhe pajisjet teknologjike në bankat e shkollave të ciklit të parë, që gjithashtu ngjalli debat të gjerë në Francë.

## Imigrimi në Gjermani, rritet numri i ballkanasve

Në vitin 2017 ka rënë numri i përgjithshëm i migrantëve që kanë ardhur në Gjermani, megjithatë Gjermania mbetet një vend atraktiv, sidomos për qytetarët e BE-së. Shënon sërish rritje numri i të ardhurve nga Ballkani.

Imigrimi në Gjermani shënon rënie në përgjithësi. Në vitin 2017 kanë ardhur 416.000 njerëz më shumë në Gjermani se sa janë larguar. Sipas Zyrës Federale të Statistikave në Visbaden, ardhjes së 1,551 milionë vetëve i qëndron përballë një shifër tjetër, largimi i 1,135

milionë njerëzve. Në vitin 2016 imigrimi në Gjermani shënonte shifra më të larta, 500.000 vetë më shumë erdhën krahasuar me ata që u larguan. 90% e atyre që kanë ardhur në Gjermani janë të huaj, pjesa tjetër janë gjermanë, ku bëjnë pjesë edhe gjermanët e ardhur nga vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. Ndër të huajt e ardhur në Gjermani numrin më të madh e përbëjnë qytetarët që vijnë prej vendeve të Bashkimit Europian. 239.000 gjithsej. Më së shumti Gjermaninë e synojnë qytetarët



rumunë (73.000), ata polakë (34.000), kroatë (33.000) dhe bulgarë (30.000) vetë. Në vitin 2017, ndryshe nga viti 2016, ka pasur një rritje të numrit të ardhurve nga vendet e Ballkanit. Nga Kosova

kanë ardhur gjithsej 8000 vetë vitin e kaluar, ndërsa nga Shqipëria nëse viti 2016 shënoi një rënie me 26.000 vetë të shqiptarëve, në 2017-n ky numër u rrit me 1000 vetë. Nga Serbia erdhën 6000 vetë, po kaq edhe nga Maqedonia. Nga vendet aziatike kanë ardhur 140.000 vetë, nga vendet europiane jashtë BE-së kanë ardhur 60.000 vetë gjithsej, ndërsa nga Afrika 35.000 imigrantë. Ndërkohë ka rënë ndjeshëm numri i të ardhurve nga Siria, Afganistani dhe Irani.





Republika e Maqedonisë  
Agjencia për ushqim dhe veterinar



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 alineja 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/04, 199/14, 27/16 dhe 35/18), ndërsa në pajtim me nenin 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – tekst i konsoliduar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/15, 27/16 dhe 120/18) Agjencia për ushqim dhe veterinar e Republikës së Maqedonisë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR  
nr. 1/2018

Për nevojat e Agjencisë për ushqim dhe veterinar të Republikës së Maqedonisë, publikohet shpallje për plotësim të vendeve të punës, për periudhën deri më 31.12.2018.

**1. Emri i institucionit:** Agjencia për ushqim dhe veterinar e Republikës së Maqedonisë

**2. Në vendin e punës nr. 1:** Këshilltar për lloje të ndryshme të ushqimeve dhe aditivëve në Departamentin për shtojca për ushqim dhe aditivë, ushqim për përdorim të posaçëm nutritiv dhe ushqim i pasuruar, Sektori për ushqim me prejardhje joshnozore, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Medicina veterinare, shkencat mjekësore, biologji niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,

- Përvoja e punës: së paku tri vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 25.123,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 2:** Këshilltar për siguri në ushqim në Departamentin për siguri dhe kualitet të ushqimit me prejardhje shtazore, Sektori për shëndet publik veterinar, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Medicina veterinare, niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,
- Përvoja e punës: së paku tri vjet përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 25.123,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 3:** Këshilltar për kualitetin e ushqimit me prejardhje shtazore në Departamentin për siguri dhe kualitet të ushqimit me prejardhje shtazore, Sektori për shëndet publik veterinar, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Medicina veterinare, niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,
- Përvoja e punës: së paku tri vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 25.123,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 4:** Këshilltar inspektor – inspektor shtetëror i ushqimit NJP Makedonski Brod në Departamentin e inspektoratit shtetëror për ushqim me prejardhje joshnozore, Sektori për mbikëqyrje inspektuese, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Shkencat mjekësore, Medicina veterinare, shkencat e tokës dhe hidrologjisë, niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,
- Përvoja e punës: së paku tri vjet përvojë pune në profesion.
- Kushte tjera të posaçme: licencë për inspektor

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 25.123,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 5:** Bashkëpunëtor për kontakt me konsumatorët në Departamentin për mbrojtje të konsumatorëve, Sektori për mbështetje profesionale, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Shkencat mjekësore, teknologjia ushqimore, medicina veterinare, niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,
- Përvoja e punës: së paku një vjet përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 22.588,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 6:** Inspektor i ri për inspektim të ushqimit NJP Manastir në Departamentin e inspektoratit shtetëror për ushqim me prejardhje joshnozore, Sektori për mbikëqyrje inspektuese, (1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Shkencat mjekësore, biologji, bioteknologji, niveli i kualifikimeve VI B sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar,
- Përvoja e punës: me ose pa përvojë pune në profesion

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 21.067,00 denarë.

**Në vendin e punës nr. 7 : Referent i lartë për evidencë dhe arkivim** në Departamentin për koordinim dhe kontroll të laboratorëve, Sektori për mbështetje strukturore,

(1) – realizues,

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme:**

- Lloji i arsimit: Arsim i lartë/i mesëm – kimi, medicinë, ekonomi, niveli i kualifikimeve V A ose niveli i kualifikimeve IV sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsim të lartë ose të mesëm,
- Përvoja e punës: së paku dy vjet përvojë pune në profesion.

**Kompetencat e përgjithshme të punës:**

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij,

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- arritje të rezultateve,
- puna me të tjerë/puna ekipore,
- ndërgjegjësim strategjik,
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar.

**Kompetencat e posaçme të punës:**

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

**Orari i kohës së punës:**

- Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë punë (08:30-16:30), përshkrimi për vendin e punës me fillim të orarit të punës mes 07:30 dhe 08:00 dhe mbarim të të njëjtit mes 15:30 dhe 16:30.

**Neto shuma e pagesës në të holla:**

- 14.981,00 denarë.

Kandidatët e interesuar duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Certifikatë/diplomë për arsimin e mbaruar përkatës,
- Fotokopje të certifikatës së shtetësisë,
- Vërtetim se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalese për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se një vit,
- Vërtetim për punën me kompjuterë,
- Vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (të lartpërmendura),
- Vërtetim për përvojën e punës

Shpallja publike zgjatë 3 (tri) ditë pune nga dita e publikimit. Orari i punës është prej ora 08:30 deri në ora 16:30 prej ditës së hënë deri ditën e premte, 40 orë në javë. Punësimi është për kohë të caktuar deri më 31.12.2018.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në pajtim me nenin 23 të Ligjit për marrëdhënie pune.

Fletëparaqitjet së bashku me autobiografi parashtrihen me zarf të mbyllur me shenjë për shpallje për punësim nr. 1/2018 deri në Agjencinë për ushqim dhe veterinar të Republikës së Maqedonisë, bul. Brigada e III Maqedonase nr. 20, 1000 Shkup, përmes arkivit ose postës.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrihen brenda afatit të caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk do të përmbajnë dokumentet e nevojshme, do të llogariten si të vonuara dhe të pakompletuara dhe nuk do të shqyrtohen. Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që i përmbushin kushtet.



Deri

## Lënda: Kërkesë për parashtrimin e Ofertës – Sigurim fizik për nxënësit

Ju dërgojmë Kërkesë për parashtrim të Ofertës për: Sigurim fizik të nxënësve.

-Kriteri për ndarjen e marrëveshjes është çmimi më i ulët, gjegjësisht, ai i cili do të ofrojë çmimin më të ulët.

-Bartësi i furnizimit është i obliguar të bëjë sigurimin çdo ditë pune prej ora 7.00 deri ora 19.30 pasdite.

-Bartësi i furnizimit obligohet që të sigurojë sigurim kualitativ për nxënësit çdo ditë pune gjatë vitit shkollor prej ditës së nënshkrimit të marrëveshjes deri më 31.10.2019.

-Mënyra e pagesës përmes fletëpagesës në llogarinë e paguar nga prindi.

### Mënyra e parashtrimit të fletëparaqitjes:

Ofertuesi e parashtron kopjen origjinale në zarf të brendshëm të vulosur që përmban emrin e ofertuesit me adresë të plotë dhe të saktë.

Zarfi i brendshëm dorëzohet në zarf të jashtëm të vulosur i cili:

- Është i adresuar me adresë të saktë të organit kontraktues,
- Çmim me TVSH të përlogaritur për nxënës
- Në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "Mos hap", të mos hapet para kohës dhe datës për hapje të ofertave.

Nëse të gjitha zarfet nuk janë të vulosura dhe të shënuara siç kërkohet, organi kontraktues nuk merr përgjegjësi për dëmtim ose hapje të parakohshme të ofertës. Zarfi nuk duhet të përmbajë asnjë shenjë me të cilën do të mund të identifikohet dërguesi – ofertuesi..

Oferta duhet të përbëhet nga elementet në vijim dhe sipas radhitjes në vijim:

- Formular të plotësuar të ofertës (Shtojca 1);
- Dëshmi për veprimtari të regjistruar;
- Leje për sigurim të personave dhe pronës;

Oferta e pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e Komisionit.

### Afati për parashtrimin e Ofertës:

Oferta duhet të parashtrohet në afat prej pesë ditëve të punës duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Dorëzuar deri te:

-titulli

Në bazë të shpalljes të publikuar nga ana e SHMKP "Kole Nedellkovski" Veles, për kërkesë për grumbullimin e ofertave për: Sigurim të nxënësve për nevojat e SHMKP "Kole Nedellkovski", në vijim parashtrime:

OFERTË

### Pjesa I – Informatat për ofertuesin

I.1. Emri i ofertuesit: \_\_\_\_\_

I.2. Informacionet për kontakt

- Adresa: \_\_\_\_\_
- Telefoni: \_\_\_\_\_
- Faksi: \_\_\_\_\_

- E-Mail: \_\_\_\_\_

- Personi për kontakt: \_\_\_\_\_

I.3. Personi përgjegjës: \_\_\_\_\_

I.4. Numri tatimor: \_\_\_\_\_

I.4. Numri i vetëm amë i subjektit: \_\_\_\_\_

### Pjesa II– Oferta teknike

II.1. Të bashkëngjitur parashtrime dokumentet e kërkuara edhe atë:

\_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

### Pjesa III – Oferta financiare

SPECIFIKACIONI PËR ÇMIMIN SA KUSHTON SIGURIMI PËR NXËNËS						
ÇMIMI PËR NJË NXËNËS						
Nr. rend	Përshkrim			Çmimi individual pa TVSH	TVSH	Çmimi i përgjithshëm
	Çmimi i shërbimit për një nxënës					

III.2 Oferta jonë vlen për periudhën e caktuar në pajtim me kërkesat e organit kontraktues. Pajtohem me mënyrën e pagesës.

III. 4. Me parashtrimin e kësaj oferte, në tërësi pranojmë kushtet e parapara nga ana e organit kontraktues

Vendi dhe data	Personi përgjegjës
_____	_____
	(vulë dhe nënshkrim)

Në bazë të nenit 50 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 14 e Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), në lidhje me nenin 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05....120/18), ndërsa në lidhje me nenin 11 të Ligjit për zjarrfikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/04....39/16), në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në administratën komunale të komunës së Sveti Nikoles nr. 0901-218/3 të datës 12.09.2018, Kryetari i Komunës Sveti Nikole publikon:

### SHPALLJE PUBLIKE

#### Për praninë të personave të autorizuar zyrtar në sferën e sigurisë – zjarrfikës profesionistë në marrëdhënie të rregullt pune për kohë të pacaktuar

Komuna Sveti Nikole publikon shpallje për punësim të 2 (dy) realizuesve për vendin e punës në vijim:

1. POZH 02 10 V03 000 Zjarrfikës shpëtimtar – teknik– 2 (dy) realizues

Kushtet e përgjithshme, të cilat i përmbushë kandidati janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme, që duhet të përmbushë kandidati janë:

- Kualifikimet profesionale: niveli i kualifikimeve IV sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të aritura 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsim të lartë ose të mesëm;
- Përvojë e punës: së paku një vit përvojë pune në profesion të evidentuar në Agjencinë për punësim të Republikës së Maqedonisë si stazh të punës;
- Leje të vozitjes të kategorisë "C" ose "D".

Kompetencat e përgjithshme të punës në nivel themelore:

- mësim dhe zhvillim;
- komunikim;
- arritje të rezultateve;
- punë me të tjerë/punë ekipore;
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe

Orari i punës është o organizuar me ndërrime dhe zgjatë prej 160 deri 184 orë në muaj.

Neto shuma në të holla e përmbledhjes së pjesës së rrogës për shkallën e arsimit dhe pjesa e pagesës për nivelin është 15.853.00 denarë.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjes me dëshmitë zgjatë 3 (tre) ditë pune. Fletëparaqitja me dokumentet duhet të parashtrohet përmes postës, në adresën: Komuna e Sveti Nikoles, rruga "Sheshi linden" nr. 12, 2220 Sveti Nikole ose personalisht në arkivin e Komunës Sveti Nikole (me shenjë për Shpallje publike për punësim të personave të autorizuar zyrtar në sferën e sigurisë – zjarrfikës profesional). Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët në fletëparaqitje obligohen që nën përgjegjësi materiale dhe penale të vërtetojnë se të dhënat janë të sakta, ndërsa dëshmitë e parashtruara të besueshme me origjinalin.

Për informacione plotësuese, kandidatët e interesuar të drejtohen në 032 444 169 në Komunën e Sveti Nikoles – Departamenti për menaxhim me resurset njerëzore.

Vërejtje: Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit të fletëparaqitjeve.

Punësimet e parapara sipas planit të punësimit në institucion për vitin 2018 janë Maqedonas/e.

Procedurën do ta realizojë Komisioni për përzgjedhje i formuar nga ana e Kryetarit të Komunës Sveti Nikole dhe sipas procedurës së realizuar do të bëhet zgjedhja.

KOMUNA SVETI NIKOLE  
Kryetari i Komunës

M-r Sasho Vellkovski

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-11546/2 të datës 08.10.2018, si dhe Vendimit për publikim të Shpalljes publike nr. 02-656/1 të datës 17.10.2018, nga UD Drejtori i IPSh Shtëpia e shëndetit – Ohër, IPSh Shtëpia e shëndetit – Ohër publikon

### SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorëve shëndetësor për kohë të pacaktuar

1. IPSh Shtëpia e shëndetit – Ohër ka nevojë për punësim të 3 (tre) doktorëve të medicinës për kohë të pacaktuar dhe 2 (dy) motra medicinale për kohë të pacaktuar.

2. Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me nenin 158 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore, edhe atë:  
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,  
 - të jetë i moshës së rritur,  
 - të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe  
 - të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga pika 2 kandidatët për Doktor të medicinës duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:

- arsim sipëror të mbaruar (VII/1) ose 240 kredi sipas SETK – Fakulteti i medicinës
- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
- njohje të një prej gjuhëve të huaja
- me dhe pa përvojë pune.

Orari i punës është 40 orë. Neto pagesa themelore për Doktor të medicinës është 25.968,00 denarë, pa të shtesa të pagesës.

4. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga pika 2 kandidatët për motër medicinale duhet të përmbushë kushtet e posaçme në vijim:

- arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (PMP shkalla IV)
- certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë
- provim të dhënë profesional
- me dhe pa përvojë pune.

Orari i plotë i punës – punë me ndërrime. Neto pagesa themelore për motër medicinale është 16.648,00 denarë.

6. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për Doktor të medicinës obligohen që të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar ose certifikatë për Fakultet të mbaruar të medicinës origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

-Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter  
 -Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter  
 -Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter

-Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter  
 -Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter  
 -Licencë për punë për veprimtarinë doktor i medicinës, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter  
 -Dëshmi për njohje të gjuhës së huaj (angleze, gjermane ose frënge).

7. Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për motër medicinale obligohen që të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar ose certifikatë/dëftesa për arsim të mbaruar për të gjitha vitet, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
- Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë.

9. Afati për paraqitje në shpallje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

10. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

11. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur që i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet përzgjedhja në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 dhe paragrafi 3 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

12. Fletëparaqitja me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, parashtrorin në IPSh Shtëpia e shëndetit – Ohër rr. Dimitar Vlahov 69 Ohër përmes postës në arkivin e IPSh Shtëpia e shëndetit Ohër, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSh Shtëpia e shëndetit – Ohër



UDHËKRYQE (TEATRORE) NGA KUMANOVA

# AKTORËT SHQIPTARË PA KULM MBI KRYE

Përvite me radhë Teatri shqiptar i Kumanovës përballlet me kushte mizore dhe mungesë të hapësirave, këtë e konfirmuan edhe aktorët e Kumanovës. Edhe përkundrejt premtimeve të bëra nga ana e qeverisë, ende nuk kanë paraparë ndonjë plan konkret lidhur me përmasimin e kushteve dhe hapësirave të cilat kushtëzojnë numrin e shfaqjeve



kërkuar nga organet kompetente që të marrin masa për rikonstruimin e objektit, mirëpo që kjo kërkesë deri më tash ka arritur në vesh të shurdhët, duke përfshirë edhe qeverinë e aktuale e cila kishte premtuar zgjedhjen e problemit të teatrit të Kumanovës.

Aktorët për gazetën KOHA, u shprehën se kushtet në teatrin e Kumanovës janë mizore dhe se këshilli i aktorëve do të vazhdojnë të kërkojnë edhe më tutje përmirësimin e kësaj gjendje nga organet kompetente si dhe për hapësirë që të mund të funksionojnë më

shumë grupe njëkohësisht.

"Kushtet mizore shihen që në shikim të parë duke filluar nga mungesa e hapësirës, veshtoreve dhe kushteve tjera elementare të cilat vështirësojnë punën dhe përgatitjet për një shfaqje. Mirëpo përkundrejt premtimeve se do të punohet, ende nuk kanë filluar ndonjë punë konkrete dhe nuk jemi në dijeni se çfarë plane do të kenë në të ardhmen", deklaroi aktori nga Kumanova, Qazmedin Nuredini.

Mes të tjerash ai shtoi se mungesa e hapësirës i kushtëzon ata

në numrin e shfaqjeve, sepse duhet të koordinohen edhe me ekipet maqedonase për shkak hapësirës së pa mjaftueshme ku duhet ti zhvillojnë provat.

Drejtori i Pallatit të Kulturës, Sasho Todorovski për gazetën KOHA deklaroi se janë në bisedime me Ministrinë e Kulturës, por deri më tani asgjë nuk është konkrete.

"Duhet shumë punë, besoj që do të fillojmë më rikonstruimin e kulmit fillimisht dhe më tutje do të shohim, nuk mund të deklaroi diçka sepse ende nuk është asgjë

konkrete, prandaj do të presim.

Lidhur me objektin e teatrit në Kumanovë, nga Ministria e Kulturës, në programet për ndërtimin e objekteve të reja dhe për rikonstruimin, rehabilitimin dhe adaptimin e objekteve ekzistuese që i përdorin institucionet nacionale në sferën e kulturës në vitin 2016 dhe 2017, kishin parashikuar projekte për riparimin e të kulmit të objektit të Qendrës së Kulturës dhe objektit të teatrit. Nga Ministria shtuan se Qendra e Kulturës "Trajko Prokopiev" – Kumanovë ka realizuar aktivitetin vetëm për rikonstruimin e kulmit të Qendrës së Kulturës në vitin 2016 dhe 2017, në vlerë prej 2.981.860 denarëvë.

"Sektori për çështje investuese ka kryer shumë vizita pune në Kumanovë, ka parashikuar dhe përcaktuar punë të nevojshme për rikonstruimin e objektit të teatrit dhe ka përpiluar detyrë projektuese për hartimin e dokumentacionit projektues për rikonstruimin e objektit, për shkak se i njëjti është në gjendje të keqe dhe për të cilin nevojitet rikonstruim komplet.

Ndërsa për vitin 2019 është paraparë ndërtimi i nënstrukturës së kulmit dhe mbulesa e ndërtesës së teatrit Kumanovë", deklaruan nga Ministria.

Koha

Remzije BILALLI

Shkup, 17 tetor - Teatri në Komunën e Kumanovës po përballlet me probleme të ndryshme, duke filluar që nga mungesa e hapësirave, mungesë të zhveshtoreve, rënia e kulmit dhe shumë probleme të tjera të cilat ndikojnë dhe përkufizojnë numrin e shfaqjeve. Ky problem disa vjeçar ka ndikuar në zhvillimin e kulturës së teatrit në Kumanovë. Aktorët shqiptarë të cilët për disa vite me radhë kanë

Në orën e madhe letrare 'Globi poetik', përveç leximit të poetëve do t'i ndahet edhe çmimi i madh letrar dhe do t'i jepet titulli Anëtar Nderi, lauretit të këtij viti, poetit zviceran Beat Brechbuhl si dhe do të ndahet edhe çmimi letrar "Ditët e Naimit".

Prej 18-22 tetor 2018, në Tetovë dhe në Pogradec do të mbahet Edicioni i 22-të i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit". Ate do ta karakterizoj një program i ngjeshur letrar, artistik dhe kulturor. Në te do të mbahen katër lexime letrare, do të promovohen 5 libra të rinj të shtëpisë botuese "Ditët e Naimit", si dhe do të bëhen vizita të ndryshme në monumentet kulturore, historike dhe fetare në qytetin e Tetovës dhe ate të Pogradecit.

Në Edicionin e 22-të të Festivalit Ndërkombëtar i Poezisë "Ditët e Naimit" marrin pjesë poetë nga vende të ndryshme të botës, si: Beat Brechbuhl (Zvicër), Gerry van der Linden (Holandë), Kristian Guttesen (Islandë), Gloria Sofia (Por-

## FILLON EDICIONI I XXII I FNP "DITËT E NAIMIT"



tugali), Elizabeth (Malta), Marisol Bohoruez (Kolumbi), Eliza Segiet (Poloni), Licilla Trapazo (Zvicër), Rokiah Hashi (Malajzi), Primozh Repar (Slloveni), Natalia Trevino (SHBA), Moan Shalaba (Izrael), Gema Bocado (Spanjë), Jon Hoyer (Danimarkë), Giuseppe Napolitano (Itali), Noah Avala (Porto Riko), Silke Liria Blumbach (Gjermani), Elena Prenxhova dhe Slagjana Bojanovska (Maqedoni), Erina Çoku, Ylli Çela dhe Arjan Kallço (Shqipëri), Brahim Avdili dhe Ndue Ukaj (Kosovë), Bardhyl Zaimi dhe Remzi Salihu (Maqedoni).

Hapja e ceremonisë së Edicionit të XXII TË Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë "Ditët e Naimit" do të bëhet te enjten në orën 19.30, përmes një performance fishekzjesh

para Qendrës së Kulturës "Naim Frashëri", në Tetovë. Drejtori i Festivalit, Shaip Emërllahu, laureati zviceran Beat Brechbuhl, ministri kulturës z. Asaf Ademi, kryetarja e Komunës së Tetovës zonj. Teuta Arifi si dhe një delegacion nga Komuniteti Bektashian do të vendosin buqete lulesh para shtatores së poetit "Naim Frashëri". Në hyrje të Qendrës së Kulturës, publikut edhe në këtë hapje do t'iu dhurohet Antologjia e këtij edicioni dhe libra të tjerë të rinj të Festivalit.

Më pas në Sallën e Madhe do të bëhet hapja zyrtare e Programit të Edicionit të 22 të FNP "Ditët e Naimit", ku hapjen do ta bëjë ministri i Kulturës z. Asaf Ademi, ndërsa një fjalë përshëndetëse do ta mbajë kryetarja e Komunës së Te-

tovës, zonj. Teuta Arifi dhe drejtori i Festivalit z. Shaip Emërllahu.

Në hapje të këtij Edicioni, aktori Arsim Kaleci do të recitoj poezinë "Fjalët e Qiririt" të Naim Frashërit, ndërsa nga një pikë muzikore me piano, violinë dhe në flautë do të ekzekutojnë virtuoz të muzikës klasike.

Në orën e madhe letrare 'Globi poetik', përveç leximit të poetëve do t'i ndahet edhe çmimi i madh letrar dhe do t'i jepet titulli Anëtar Nderi, lauretit të këtij viti, poetit zviceran Beat Brechbuhl si dhe do të ndahet edhe çmimi letrar "Ditët e Naimit". Titullin e lartë, Anëtarë Nderi të Festivalit, deri tani, e kanë marrë shkrimtarët dhe intelektualët e njohur, si Ismail Kadare (Shqipëri), Desmond Egan (Irlandë), Thomas Tidholm (Suedi), Manlio Argueta (Salvador), Abdelatif Laabi (Marok), Peter Poulsen (Danimarkë), Lionel Ray, (Francë), Eva Lipska (Poloni), Craig Czury (SHBA), Tua Forsstrom (Finlandë), Athanase Vantchev de Thracy (Francë), Sebastiano Grasso (Itali), Kuei shien Lee (Taivan), Xhorxh Valas (SHBA) etj.

Në ditën e dytë të Programit, në sallën e hotelit "Lirak" do të bëhet përrurimi i pesë titujve të rinj

të shtëpisë botuese "Ditët e Naimit". Libri me poezi i laureatëve Beat Brechbuhl, i George Wallas dhe Kuei shien Lee, i drejtorit të Festivalit Shaip Emërllahu, si dhe antologjia e poetëve pjesëmarrës të këtij edicioni "Pështjellimi i dendur" i përgatitur nga Shaip Emërllahu. Për këto libra do të flasën poetët dhe studjuesit Ndue Ukaj, Xhelal Zejneli, Remzi Salihu dhe Bujar Plloshani. Pasdite pjesëmarrësit do të vizitojnë Galerinë e Kombëtare në Shkup, dhe në mbrëmje do të mbajnë orën letrare "Poetë dhe vargje". Të shtunën poetët do të vizitojnë monumentet kulturore dhe artistike në Tetovë dhe pasdite do të shkojnë për në Pogradec. Atje, në bashkëpunim me Bashkinë e Pogradecit do të mbajnë orën e madhe letrare "Meridianet poetike", do të ndahen çmimet tjera letrare të Festivalit, si dhe poetët do të vizitojnë objekte të ndryshme kulturore dhe historike të këtij qyteti buzë Liqenit të Ohrit.

Festivali këtë vit mbështetet nga Ministria e Kulturës së Republikës së Maqedonisë, Komuna e Tetovës, Bashkia e Pogradecit, si dhe sponsorët; kompania "Vezë Sharri", restorant "Arbi" dhe restorant "Kurtishi"/Dimal Hadri



LIGA E KOMBEVE

# ANGELOV: TË GJITHË KEMI GABUAR

Ndaj Armenisë të gjithë kemi gabuar duke filluar nga un lojtarët dhe referit që po e thoni ju. Para ndeshje e thash se duhet të jemi shumë të koncentruar, por këtë nuk e bëmë. Para nesh na presin takime tjera për të luajtur. Duhet që të kthemi para se gjithash në aspektin psikologjik pas gjithë kësaj që ndodhi", theksoi Angelovski

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 17 tetor - Reprerentacioni i Maqedonisë në futboll ka shijuar humbjen e parë në garat e Ligës së Kombeve, në grupin e 4 të Divizionit D. Maqedonia në takimin e zhvilluar në Erevan ka pësuar disfatë të thellë 4:0 nga Armenia. Goli i parë për vendasit erdhi në minutën e 12 me anë të Markos Pice-li, pas një gabimit trashanik të portierit të Maqedonisë, Stole Dimitrievski. Në minutën e 67 të pjesës së dytë përsëri armenët shënojnë kësaj herë me anë të Jura Movsisjan. Ndërkaq, goli i tretë dhe i katërt u shënuan nga Gazirain në minutën e 81 dhe Mikhtarian në minutën e 90. Maqedonia takimin e mbylli me një futbollist më pak, pas kartonit të dytë të verdhë të Elif Elmas në kohën shtesë.



së. Në këtë mënyrë, pas 16 muajsh pa disfatë, Maqedonia pësoi disfatë në Erevan. Trajneri Igor Angelovski pas takimit ka folur rreth takimit ku ka theksuar se nuk duhet askush të fajësohet për humbjen por faji është i të gjithëve. "Unë i zgjedh lojtarët që kush do të luaj dhe për atë nuk duhet askënd të fajësojmë. Çdo kush ka një ditë të keqe, përfshi edhe referat. Nuk dua të komentoj referimin, këtë gjë asnjëherë nuk e kam bërë. Ndaj Armenisë të gjithë kemi gabuar duke filluar nga un lojtarët dhe referit që po e thoni ju. Para ndeshje e thash se duhet të jemi shumë të koncentruar, por këtë

nuk e bëmë. Para nesh na presin takime tjera për të luajtur. Duhet që të kthemi para se gjithash në aspektin psikologjik pas gjithë kësaj që ndodhi", theksoi Angelovski, i cili më pas tha se nuk i befusuar me mënyrën se si lozi Armenia. "Nuk ja i befusuar nga loja e Armenisë. Këtë takim nuk e humbëm për arsye taktike por për gabimet individuale që bëmë. Isha i befusuar kur Armenia u mposhtë nga Gjibraltari, por për këtë futbollin është sporti më i bukur, pasi çdo kush mund të fiton", deklaroi Angelovski. Nga ana tjetër Enis Bardhi është i revoltuar pas humbjes si dhe për penaltinë e pa-

stër që nuk u referua në pjesën e parë të takimit që ndoshta ndeshja të kishte marrë kahje krejtësisht tjetër nëqoftëse ishte akorduar. "Ndërhyrja ndaj meje ishte penalti e pastër, ku të gjithë e panë. Por vetëm referi një gjë të tillë nuk e vërejti, ku habitem se si mund të bënë atë gabim, pasi lojtari kundërshtari nuk preki topin po goditi këmbën time. Ajo penalti ndoshta do të kishte ndryshuar ndeshjen. Po, ajo është tani më e kaluar dhe nuk mund të kthehet mbrapa. Neve duhet të harrojmë këtë episod të keq, dhe deri në fund të luftojmë për vendin e parë në tabelë", deklaroi Enis Bardhi.

## Seferi shkëlqen me Shqipërinë



Taulant Seferi ishte autori i dy golave mbrëmjen e sotme për kombëtaren U-21 në sfidën kundër Estonisë. Ishte minuta e 12 e takimit, kur mesfushori i krahut të majtë të kuqezinjve të vegjël, arriti të gjej rrjetën duke kaluar në avantazh kombëtaren tonë përballë Estonisë. Goli i dytë ishte dhe më i bukur se i pari, pas një asistimi të bukur nga Esat Mala, Seferi shënon sërish kundër Estonisë. Ndonëse ekipi ynë kombëtar nuk pati fat sonte, golat e Seferit por dhe forma e tij e mirë që po kalon me klubin e Winterthur, është një lajm i mirë për kombëtaren tonë. Pas sfidës me Estoninë, Taulant Seferi ka treguar emocionet e dygolshit të sotëm. "Jam shumë i lumtur që e mbylla ndeshjen me dy gola. Por nuk jam i lumtur me rezultatin sepse e dominuam ndeshjen për 90 minuta, por s' patëm fat. Falënderoj Zotin që shënova për Shqipërinë time. Goli im është për gjithë kombin shqiptar, familjen dhe shoqërinë time. Më kanë uruar shumë njerëz, u jam mirënjohës të gjithëve dhe unë i falënderoj të gjithë. Ky gol nuk dua të them që ishte mesazh për kombëtaren A, sepse për çdo gjë vendos trajnerin. Unë lus Zotin që të vazhdoj kështu, sepse besoj se ftesa nuk do të më mungoj", ka deklaruar Taulant Seferi.

## Tifozët e Rangersit duan Grezdën në fushë



Mesfushori i kombëtares shqiptare, Eros Grezda, bëri hapin e madh në karrierë duke kaluar nga Osijek-u në ligën e parë kroate drejt Rangers-it në kampionatin skocez të futbollit. Shqiptar do ta ketë të vështirë përshtatjen në kampionatin ishullor dhe për shkak të konkurrencës së madhe që ka në skuadër. Dëmtimi që pësoi dhe e mbajti gjatë jashtë fushave ka ndikuar në minutat e tij në fushën e lojës, pasi 23-vjeçari nuk është ende në formën e tij më të mirë. Dy ndeshjet e fundit me Shqipërinë ndaj Jorda-

nisë dhe Izraelit e treguan qartë se lojtari ka probleme fizike. Futbollin ndonjëherë është dhe çështje fati. Shqiptari mund të buzëqeshë fshehurazi me dëmtimin e shokut të tij të ekipit, Scott Arfield. Ky i fundit titullar i rëndësishëm në formacionin e Steven Gerrard dhe i afruar prej legjendës në merkaton e verës nga Burnley. 29-vjeçari është rivali direkt i Grezdës për formacionin e ekipit të Rangers-it. Arfield ka pësuar një dëmtim muskolor me kombëtaren e tij të Kanadasë. Ai rezikon 3 ndeshjet e ardhshme të ekipit skocez. Një dhimbje koke për Gerrard, por për Grezdën është një mundësi e mirë për të fituar minuta dhe pse jo të luajë si titullar për herë të parë. Tifozët e Rangers-it i kanë kërkuar trajnerit anglez që të aktivizojë mesfushorin shqiptar nga minuta e parë. Gerrard ka besim te aftësitë e shqiptarit, prandaj e ka blerë, por gjendja e tij fizike mbetet ende shqetësimi kryesor i tij. Gjakovari duhet ta shfrytëzojë si duhet shansin e tij dhe të bindë se meriton më shumë.

## Mustafi i fiksuar me seritë televizive



Kampion i botës me Gjermaninë në 2014-ën, por më pas i paafte për të vazhduar në nivele të larta me "Die Mannschaft", edhe pse luan te një klub i madh europian si Arsenal, Shkodran Mustafi është një nga protagonistët e momentit të mirë që po kalojnë "Topçinjtë", të cilët e nisën me dy humbje në kampionat nën drejtimin e Emery. Paraqitjet e mira të qendërmbrojtësit janë akoma më mbresëlënëse duke parë stilin e jetës që ndjek ai. Jetë nate? Jo, sepse "mëkati" që Mustafi i lejon vetes është shtëpiak, por po aq i dëmshëm. Mbrojtësi me origjinë shqiptare, në fakt, ka zbuluar në faqen zyrtare të klubit në internet se është i fiksuar me seritë televizive. Ka lindur gjithçka rastësisht, por më pas... "Verën e

kaluar, gjatë grumbullimit, kam zbuluar Prison Break", ka kujtuar Mustafi. " Ishim në Australi dhe unë isha zgjuar, teksa të gjithë të tjerët po flinin. Nuk kisha asnjë me kë të kaloja kohën dhe e vetmja gjë që mund të bëja isha të shikoja seritë, paradite dhe në mbrëmje". Subjekti e ka bërë për vete Mustafin: "Edhe nëse në mëngjes kishim stërvitje, unë qëndroja zgjuar deri në tre të mëngjesit për të shikuar episodet. Çdo natë i thoja vetes se do të flija herët, por rrija deri natën vonë". Një varësi e vërtetë, që duket se nuk po ndikon te rendimenti i lojtarit, i cili ka luajtur në të gjitha ndeshjet e Premier League në këtë sezon, nga minuta e parë tek e fundit. Ndoshta për meritë të "Prison Break".





REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës Publikon

### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 222/2018

për punësimin e 2 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komonën e Sarajit“ për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për resurse njerëzore

1 realizues(ë)  
- Orët javore të punës 40  
- Orari ditor i punës 08:30 - 16:30  
Rroga neto: 28.757,00 denarë

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike, Shkencat Politike ose Shkencat e Organizimit dhe Administrimit (menaxhment)
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- çertifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës:

- Ditët e punës e hënë-e premte

Në bazë të nenit 37, 38 dhe 39 të Ligjit për Policinë Financiare („Gazeta zyrtare e RM-së“ nr. 12/14, 43/14, 33/15, 27/16 dhe 83/18), neni 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05..... 39/12, 25/13, 187/13, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe 120/18), neni 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05.....35/18), neni 17 të Ligjit për Realizimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin 2018 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 196/17), Komisioni për zbatimin e procedurës për punësim pranë Ministrisë së financave- Drejtoria e Policisë financiare publikon

### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR 04/2018

për punësimin në Drejtorinë e Policisë financiare

Drejtoria e Policisë financiare ka nevojë për punësim në kohë të

pacaktuar me orar të plotë të punës për 2 realizues, për vendin e punës në vijim:

- 1. Polic financiar – Inspektor i ri për zbulimin e veprave penale me të cilën është arritur shfrytëzimi i kundërligjshëm pronësor me vlerë të konsiderueshme** për nivelin B4 shifra FIN 02 08 B04 001, Një (1) realizues, me rrogë themelore në shumë neto prej 26.493,00 denarë.
- 2. Polic financiar – Inspektor i ri për zbulimin e shmangies së tatimit dhe pastrimit të parave dhe përfitimeve tjera përmes veprave penale** për nivelin B4 shifra FIN 02 08 B04 001: Një (1) realizues, me rrogë themelore në shumë neto prej 26.493,00 denarë.

Punësimin të 3 personave për kohë të caktuar me orar të plotë të punës për periudhë prej 1 viti për vendet e punës në vijim:

- 3. Polic financiar – Inspektor i ri për parandalim të parregullive financiare dhe mashtimeve, bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet evropian** për nivelin B4 shifra FIN 02 08 B04 001, Një (1) realizues, me rrogë themelore në shumë neto prej 26.493,00 denarë.
- 4. Polic financiar – Inspektor i ri për zbulimin e keqpërdorimeve të pozitës zyrtare** për nivelin B4 shifra FIN 02 08 B04 001, Një (1) realizues, me rrogë themelore në shumë neto prej 26.493,00 denarë.
- 5. Polic financiar – Inspektor i ri për zbulimin e krimit të organizuar financiar** për nivelin B4 shifra FIN 02 08 B04 001, Një (1) realizues, me rrogë themelore në shumë neto prej 26.493,00 denarë.

#### Kushtet e përgjithshme

- Shtetas i Republikës së Maqedonisë, i aftë psikofizikisht (person i aftë) dhe me predispozita për kryerje të punëve të policit financiar, niveli i kualifikimit VI A sipas kornizës nacionale të kualifikimeve për arsim sipëror, së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 nga sfera e shkencave juridike, ekonomike, sigurisë, njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, njohje të gjuhës angleze përmes posedimit të certifikatës nga certifikatat e njohura ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të nivelit B2, nivelit të CEFR gjegjësisht IELTS me 5-6 pikë, FCE, BEK V, ILEK, IKFE, BULATS ose TOEFIL PBT së paku 500 pikë, TOEFIL CBT së paku 175 pikë ose TOEFIL IBT së paku 60 pikë, jo më të vjetër se 5 vjet, me ose pa përvojë pune.

#### Kushtet e posaçme

- Posedon certifikatë sigurie për informacione të besueshme të nivelit më të ulët rreptësisht të besueshme, gjegjësisht në kontroll sigurie të jetë vërtetuar se nuk ekziston rrezik sigurie nga punësimi i personit me shkallë të informacioneve të besueshme të nivelit më të ulët të rreptësisht të besueshme.

#### Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Certifikatë të shtetësisë së RM, biografi personale (CV) jo më të madhe se 5 faqe, me kontakt telefon dhe adresë të nevojshme të shënuar, letër motivimi prej së paku 500 fjalë, diplomë për arsim të mbaruar, dëshmi për gjuhë angleze, në pajtim me certifikatë të kërkuara, dëshmi për njohje të aftësive të kërkuara kompjuterike, certifikatë nga SPIM për dëshmi të përvojës së kërkuar të punës (periudha e evidentuar në agjencinë për punësim si stazh të punës).
- Kontrolli i aftësive të punës për punësimin në Drejtorinë për polici financiare të kandidatëve të zgjedhur, do të realizohet nga ana e Institucionit të caktuar shëndetësor para lidhjes së marrëveshjes për punësim, ndërsa në pajtim me Rregulloren për mënyrën për kontroll të aftësive të punës për punësim në Drejtorinë për polici financiare nr. 02-28652/1 të datës 21.08.2014.
- Drejtoria për polici financiare bën kontroll sigurie të kandidatëve të zgjedhur për polici financiar para lidhjes së marrëveshjes për punësim, pas pëlqimit të dhënë paraprak me shkrim nga ana e kandidatëve, në bazë të së cilës kandidatit do t'i jepet certifikatë sigurie për informacione të besueshme të nivelit të ulët të rreptësisht të besueshme. Kandidati i cili do të refuzojë kontrollin e sigurisë do të konsiderohet se nuk ka përmbytur kushtet për të lidhur marrëdhënie pune në Drejtori.

**VËREJTJE:** Vendi i paraparë i punës për vendin e punës nga pika 1 është për shqiptar(e) I, ndërsa për vendin e punës nga pika 2 është për shqiptar(e) I në pajtim me planin vjetor të institucionit për vitin 2018

Dokumentet e lartpërmendura duhet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në Arkivin e Drejtorisë së Policisë financiare ose përmes postës në adresën në vijim:

Drejtoria e Policisë financiare  
Rr. Kej Dimitar Vllahov nr. 4, kati 4, 1000 Shkup  
Me shenjë: për **“SHPLLJE PUBLIKE NR. 04/2018”**.

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve është shtatë (5) ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit , jo i plotë dhe i parregulluar, nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e Komisionit për punësim në Drejtorinë e Policisë financiare.

Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur të cilët kanë dorëzuar fletëparaqitje të rregulluar për vendin e punës, do të realizohet intervistë në lokalet e Drejtorisë së Policisë financiare. Drejtoria e Policisë financiare do të realizojë zgjedhjen e pesë (5) realizuesve - Polic financiar në afat në pajtim me nenin 39 të Ligjit për polici financiare.

Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës për të gjitha vendet e shpallura të punës është përcaktuar hyrja prej ora 08:00 deri në 08:15 dhe dalja prej ora 16:00 deri në ora 16:15, javor ditës së hënë deri ditën e premte.

Komisioni për realizim të procedurës për punësim

Në bazë të nenit 20-g, paragrafi 1 i Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016 dhe 35/2018), neni 22, paragrafi 1, pika 1 dhe neni 23, paragrafi 1 i Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015, 27/2016 dhe 120/2018) dhe neni 160, paragrafi 1, pika 2 dhe paragrafi 3 i Ligjit për arsim sipëror („Gazeta Zyrtare e RM“ nr. 82/2018), Fakultetit juridik “Justiniani i Parë” në Shkup në përbërje të Universitetit “Shën Kiril dhe Metod” në Shkup publikon

### SHPLLJE PUBLIKE nr. 1/2018

- 1) Për punësimin e 1 (një) personi për kohë të pacaktuar në vendin e punës – udhëheqës në Departamentin për punë financiare, kontabilitet dhe materiale – 1 (një) realizues me shifër OBN 01 02 B04 011;
- 2) Për punësimin e 1 (një) personi për kohë të pacaktuar në vendin e punës – këshilltar për IKT – 1 (një) realizues me shifër OBN 01 02 VO1 009;
- 3) Për punësimin e 1 (një) personi për kohë të pacaktuar në vendin e punës – mirëmbajtës të higjienës – 1 (një) realizues me shifër OBN 04 01 AO1 002.

**- Kandidatët të cilët do të paraqiten në vendin e punës të theksuar në pikën 1) të kësaj shpallje publike, krahas fletëparaqitjes duhet të paraqesin edhe dëshmi për përmbushje të kushteve në vijim për vendin e punës edhe atë:**

**Kushtet e përgjithshme** – të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme** – kualifikimet e nevojshme profesionale: arsim sipëror (240 SETK ose shkalla VII/1), fusha shkencore: shkencat ekonomike, së paku katër vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku një vjet përvojë pune në sektorin publik, gjegjësisht së paku gjashtë vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku dy vjet në vend udhëheqës të punës në sektorin privat; **kompetencat e përgjithshme** – të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij; mësim dhe zhvillim; komunikim; arritje të rezultateve; puna me të tjerë/puna ekipore; ndërgjegjësimit strategjik; orientim kah palët/palët e interesuara; udhëheqje dhe menaxhim financiar; **kompetencat e posaçme**: njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht); njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

**Kushtet plotësuese:** licencë për punë financiare, kontabilitet dhe materiale.

**Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës:** gjatë javës çdo ditë prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8,30 – 16,30.

**Neto shuma në të holla e rrogës:** 25.900,00 denarë.

**- Kandidatët të cilët do të paraqiten në vendin e punës të theksuar në pikën 2) të kësaj shpallje publike, krahas fletëparaqitjes duhet të paraqesin edhe dëshmi për përmbushje të kushteve në vijim për vendin e punës edhe atë:**

**Kushtet e përgjithshme** – të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme** – kualifikimet e nevojshme profesionale: arsim sipëror (240 SETK ose shkalla VII/1), fusha shkencore: shkencat e informatikës dhe inxhinieria kompjuterike, elektroteknikë dhe teknologji informatike; **kompetencat e përgjithshme të punës (niveli i mesëm):** zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij; mësim dhe zhvillim; komunikim; arritje të rezultateve; puna me të tjerë/puna ekipore; ndërgjegjësimit strategjik; orientim kah palët/palët e interesuara dhe menaxhim financiar; **kompetencat e posaçme të punës:** njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht); **Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës:** gjatë javës çdo ditë prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 8,30 – 16,30.

**Neto shuma në të holla e rrogës:** 23.600,00 denarë.

**- Kandidatët të cilët do të paraqiten në vendin e punës të theksuar në pikën 2) të kësaj shpallje publike, krahas fletëparaqitjes duhet të paraqesin edhe dëshmi për përmbushje të kushteve në vijim për vendin e punës edhe atë:**

**Kushtet e përgjithshme** – të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë; në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase; të jetë i moshës së rritur; Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

**Kushtet e posaçme** – kualifikimet e nevojshme profesionale: arsimi fillor/i mesëm.

**Fillimi dhe mbarimi i orarit ditor dhe javor të punës:** gjatë javës çdo ditë prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 6-13 (ndërrimi i parë) dhe prej 13-20 (ndërrimi i dytë) dhe çdo të shtunë prej ora 6-11 (ndërrimi i parë) dhe prej 11-16 (ndërrimi i dytë). Ndërrimet ndërrohen me javë.

**Neto shuma në të holla e rrogës:** 12.800,00 denarë.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes publike, përmes kontrollimit të fletëparaqitjeve të parastruara dhe dëshmi për përmbushjen e kushteve për vendin e punës dhe intervistës së realizuar me kandidatët e paraqitur.

Fletëparaqitja duhet të përmbajë: të dhëna për kandidatin, letër të shkurtër motivuese (për kandidatët që kanë paraqitur për vendin e punës të shënuar nën pikën 1) dhe nën pikën 2) të kësaj shpallje publike); biografi të shkurtër: deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme për vendin e punës duke shënuar po/jo për secilin kusht veç e veç të shënuar në shpalljen publike; deklaratë për përmbushjen e kushteve të posaçme për vendin e punës duke shënuar po/jo për secilin kusht veç e veç të theksuar në shpalljen publike dhe deklaratë për përmbushje të kushteve plotësuese për vendin e punës duke shënuar po/jo për secilin kusht të theksuar në shpalljen publike.

Fletëparaqitja dhe dokumentet parastruohen në letër në Arkivin e Fakultetit juridik “Justiniani i Parë” në Shkup, bul. “Goce Dellçev” nr. 9b, - Shkup, në afat prej 3 ditëve nga dita e publikimit.  
Informacione plotësuese në numrin e telefonit: 02/3117-244

Fakulteti juridik “Justiniani i Parë” në Shkup



# HENRY PREZANTOHET TE MONACO

“Monaco ka një vend special në zemrën time. Këtu kam shënuar golin e parë si profesionist tregon Henry mes emocioneve në konferencën për shtyp. Edhe mundësia e parë për t'u rritur erdhi me Wenger. Nuk flas për politikën e klubit, të paktën jo tani. Ajo që ka rëndësi për mua është sfida ndaj Strasburg dhe e di që djemtë do të jenë gati”, ka deklaruar Henry



aventurën franceze. “Monaco ka një vend special në zemrën time. Këtu kam shënuar golin e parë si profesionist – tregon Henry mes emocioneve në konferencën për shtyp. Edhe mundësia e parë për t'u rritur erdhi me Wenger. Nuk flas për politikën e klubit, të paktën jo tani. Ajo që ka rëndësi për mua është sfida ndaj Strasburg dhe e di që djemtë do të jenë gati”, ka deklaruar Henry. Disa fjalë edhe për paraardhësin e tij, Jardim, kampion France në sezonin 2016-2017 dhe që kthehu klubin monegask në Champions: “Jardim do të mbetet gjithmonë në historinë e Monaco-s dhe e kam për detyrë të falënderoj duke i uruar fat”. “Titi” i ka idetë e

qarta: “Gjithçka do të varet nga momentet e ndeshjes. Duhet studjuar çdo kundërshtar. Do të jenë, sidoqoftë, edhe koncepte për të respektuar. Nuk jam i stresuar, edhe pse puna nuk do të mungojë. Do të djersijmë, por do të ketë momente edhe kur do të qeshim dhe zbavitemi. Duhet intensitet”. Por, cilët janë modelet e referimit? “Wenger dhe Guardiola. Kur shoh Zidane dhe Deschamps, sakaq, them se duhet të përiqesh të fitosh si ata. Çdokush ka idetë e tij, metodologjinë e punës”. Gjatë konferencës ka pasur edhe një moment ilariteti, kur Henry ka nisur të flasë anglisht, duke harruar që është në Francë dhe ai është francez.



## Mandzukic ndërpret bisedimet për zgjatjen e kontratës me Juven

Juventus vendosi t'i ofrojë një kontratë të re Mario Mandzukicit, por sulmuesi kroat ende nuk ka vendosur nëse dëshiron të qëndrojë në Torino. E përditshmja sportive italiane, 'Gazzetta dello Sport' raporton se 32-vjeçari nuk e di nëse do të luajë në sezonin e ardhshëm te Juventus. Ai thuhet se për momentin ka ndërprerë bisedimet rreth zgjatjes së kontratës edhe për vitet e ardhshme me kampionët e Serie A. Sipas kontratës aktuale, thuhet se lojtari fiton tre milionë e gjysmë euro në vit gjersa italianët tani po iu ofrojnë pesë milionë në vit deri më 2021. Me largimin e Gonzalo Higuainit, Mandzukic aktualisht është golashënuesi më i mirë i kampionatit duke shënuar katër gola dhe dy asistime në nëntë ndeshje. Theksojmë se për 21 milionë euro, shtatgjati ishte transferua në korrik të vitit 2015 nga Atletico Madridi për të kaluar te bardhezinjtë.

Publicitet

**Република Македонија**  
**Општина Сарај**  
ул. Рекреативен Центар б.б.  
тел: 02/ 2057-996 факс: 2057-990  
Nr.: 08-1906/8  
15.10.2018

**Republika e Maqedonisë**  
**Komuna e Sarajit**  
rr. Qendra Rekreative p.n.  
tel: 02/ 2057-996 fax: 2057-990

**Нë bazë të nenit 35 alinea 3 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (G. zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016, 64/2018 dhe 168/2018) dhe neni 46 alinea 6 nga statuti i Komunës Saraj (Fletorja zyrtare e Komunës Saraj nr. 4/2016) Kryetari i komunës Saraj e jep këtë:**

**-NJOFTIM-**  
Njoftohen të gjithë qytetarët e v.b. Rashçe se Kryetari i Komunës Saraj sjell Vendim për organizimin e :

Anketimit publik  
Prezantimit publik

Pas propozim planit –PLANI URBANISTIK PËR FSHATIN, Komuna Saraj, e vërtetuar nga Komisioni për dhënien e mendimit për propozim të planeve në territor të Komunës Saraj.  
Propozim plani me të dhënat grafike do të jetë i prezantuar në lokalet e Komunës Saraj, në periudhë prej 24.10.2018 deri më 30.10.2018 ndërsa prezantimi publik do të mbahet më 26.10.2018 prej 10.00 -11.00 ora.

Përfshirja e planit është e sipërfaqe 95.27 ha.  
Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat fizik nga lokalitet konkrete të përfshira me plan munden të dorëzojnë vërejtje me shkrim, mendime dhe propozime në fletat anketuese ose nëpërmjet sistemit e-urbanizmit. Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketim publik munden të merren në lokalet e Komunës Saraj ose nëpërmjet sistemit e-urbanizmit.

**Република Македонија**  
**Општина Сарај**  
ул. Рекреативен Центар б.б.  
тел: 02/ 2057-996 факс: 2057-990  
Nr.: 08-1909/5  
15.10.2018

**Republika e Maqedonisë**  
**Komuna e Sarajit**  
rr. Qendra Rekreative p.n.  
tel: 02/ 2057-996 fax: 2057-990

**Нë bazë të nenit 35 alinea 3 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (G. zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016, 64/2018 dhe 168/2018) dhe neni 46 alinea 6 nga statuti i Komunës Saraj (Fletorja zyrtare e Komunës Saraj nr. 4/2016) Kryetari i komunës Saraj e jep këtë:**

**-NJOFTIM-**  
Njoftohen të gjithë qytetarët e v.b. Rashçe se Kryetari i Komunës Saraj sjell Vendim për organizimin e :

Anketimit publik  
Prezantimit publik

Pas propozim planit –PLANI URBANISTIK PËR FSHATIN SHISHOVË, Komuna Saraj, e vërtetuar nga Komisioni për dhënien e mendimit për propozim të planeve në territor të Komunës Saraj.  
Propozim plani me të dhënat grafike do të jetë i prezantuar në lokalet e Komunës Saraj, në periudhë prej 24.10.2018 deri më 30.10.2018 ndërsa prezantimi publik do të mbahet më 26.10.2018 prej 11.00 -12.00 ora.

Përfshirja e planit është e sipërfaqe 68.15 ha.  
Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat fizik nga lokalitet konkrete të përfshira me plan munden të dorëzojnë vërejtje me shkrim, mendime dhe propozime në fletat anketuese. Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketim publik munden të merren në lokalet e Komunës Saraj.

**Нë bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18), neni 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18), neni 22 të Ligjit për marrëdhënie pune – Teksti i pastruar (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 167/15) si dhe Vendimit për nevojën për punësim të punëtorëve nr. 04-389/1 të datës 16.10.2018 dhe Pëlqimit të siguruar financiar nga Ministria e financave nr. 18-11567/2 të datës 04.10.2018, IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë më datë 18.10.2018 publikon:**

**SHPLLJE PUBLIKE nr. 03/2018**  
**Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar të punës**

**1.1 . Shifra dhe titulli i vendit të punës:** DEZ 03 03 G1 001 Përkëdhelës – 2 (dy) realizues

**2. Kushtet e përgjithshme:**  
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë  
- Të jetë i aftë psikikisht dhe fizikisht  
- Të njihë gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik  
- Të mos jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit veprimtarisë ose detyrës  
- Nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe  
- Të përmbushë edhe kushte të tjera të përcaktuara në aktin për sistematizim të brendshëm të vendeve të punës

**3. Kushtet e posaçme:**  
- Arsimit të mesëm katërvjeçar  
- Licencë të vlefshme për përkëdhelës  
- Me dhe pa përvojë pune

**4. Orari i kohës së punës:** - ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte  
- orët e punës në javë: 40  
- orari i punës me ndërrime:  
Ndërrimi i I: -06:00 deri më 14:00  
Ndërrimi i II – 09:30 deri më 17:30

**5. Neto shuma e pagesës në të holla:** 15.477,00 denarë

**6. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve:** 5 (pesë) ditë pune

**7. Afati në të cilin bëhet zgjedhja:** 5 ditë pune

Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët obligohen që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta. Fletëparaqitja e dorëzuar pas afatit, jo e plotë dhe e parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e punëdhënësit.

Procedura për përzgjedhje për punësim të ofruesve të shërbimeve në institucionin publik përbëhet me kontrollimin e të dhënave të shënuara në fletëparaqitjen për punësim me kushtet e theksuara në shpalljen publike dhe kontrollim të dëshmitë të parashtruar në fletëparaqitje dhe intervistë.

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i kompletuar të parashtrohen në arkivin e IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë rr. Mladinska nr. 1 2400 Strumicë, personalisht ose përmes postës.

**Kandidatët e refuzuar do të informohen me shkrim në afat prej 3 ditëve, pas çka kanë të drejtë për ankesë në afat prej 8 ditëve deri të Këshillit i shkollës së IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë.**

IPKÇF “Detska Radost” – Strumicë  
Drejtore  
Vasil Bubev

**Република Македонија**  
**Општина Сарај**  
ул. Рекреативен Центар б.б.  
тел: 02/ 2057-996 факс: 2057-990  
Nr.: 08-1911/5  
15.10.2018

**Republika e Maqedonisë**  
**Komuna e Sarajit**  
rr. Qendra Rekreative p.n.  
tel: 02/ 2057-996 fax: 2057-990

**Нë bazë të nenit 35 alinea 3 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (G. zyrtare e RM nr. 199/2014, 44/2015, 193/2015, 31/2016, 163/2016, 64/2018 dhe 168/2018) dhe neni 46 alinea 6 nga statuti i Komunës Saraj (Fletorja zyrtare e Komunës Saraj nr. 4/2016) Kryetari i komunës Saraj e jep këtë:**

**-NJOFTIM-**  
Njoftohen të gjithë qytetarët e v.b. Rashçe se Kryetari i Komunës Saraj sjell Vendim për organizimin e :

Anketimit publik  
Prezantimit publik

Pas propozim planit –PLANI URBANISTIK PËR FSHATIN GËRÇEC, Komuna Saraj, e vërtetuar nga Komisioni për dhënien e mendimit për propozim të planeve në territor të Komunës Saraj.  
Propozim plani me të dhënat grafike do të jetë i prezantuar në lokalet e Komunës Saraj, në periudhë prej 24.10.2018 deri më 30.10.2018 ndërsa prezantimi publik do të mbahet më 26.10.2018 prej 12.00 -13.00 ora.

Përfshirja e planit është e sipërfaqe 99.70 ha.  
Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat fizik nga lokalitet konkrete të përfshira me plan munden të dorëzojnë vërejtje me shkrim, mendime dhe propozime në fletat anketuese ose nëpërmjet sistemit e-urbanizmit. Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketim publik munden të merren në lokalet e Komunës Saraj ose nëpërmjet sistemit e-urbanizmit.

### URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221



# MESSI PËR 14 VITE KA REALIZUAR 389 GOLA, KA FITUAR 25 TROFE

Lionel Messi e ka festuar të martën 14-vjetorin e debutimit në fanellën e Barcelonës. Argjentinasi në këtë periudhë u bë legjendë, duke i realizuar 389 gola dhe duke i fituar 25 trofe ekiporë dhe pesë herë Topin e Artë. Gjithashtu është bërë njëri prej futbollistëve më të mirë në histori. Prandaj Barcelona ka arsye të festojë çdo 16 tetor



ndaj Espanyolit në vend të portugezitet Deco, i cili e kishte vendosur atë lojë. Messi ishte inkuadruar në minutën e 84-t. Në atë kohë "Pleshti" ishte vetëm një lojtar premtes i futbollit botëror dhe në atë kohë e veshte fanellën me numrin 30. Trajneri i Barçës në atë periudhë ishte holandezi Frank Rijkaard, i cili i ka meritat më të mëdha për ngritjen e Messit. E në skuadër gjiganti katalonjas kishte yje të klasit botëror si Puyol, Cavi, Ronaldinho e Eto'o.

**Goli i parë** - Mirëpo, për të arritur deri te goli i parë yllin argjentinasi iu desh të priste disa muaj. Në fakt ai e ka shënuar golin e parë në fanellën e Barcelonës më 1 maj të vitit 2015 kundër Albacetes.

**Tash peshon 389 gola** - Tash numri i golave të Messit është i jashtëzakonshëm. Ai ka realizuar 389 gola në 426 ndeshje. Messi ishte i frikshëm për portierët kundërshtarë dhe për mbrojtësit po ashtu. Driblimet e tij, preciziteti,

shpejtësia dhe klasi e veçojnë yllin argjentinasi, i cili u rrit në Spanjë.

**25 trofe** - Si rezultat i paraqitjeve të mira dhe golave të shënuar sigurisht që pritëshin edhe shpërblimet. Andaj Messi gjatë karrierës së tij i ka fituar 25 trofe me Barcelonën, një rekord absolut, duke i kaluar edhe legjendat si Xavi e Iniesta, me të cilët e fitoi pjesën dërrmuese të trofeve.

**5 Topa të Artë** - Paraqitjet individuale të Messit janë shpërblimet edhe ndërkombëtarisht. Në fakt ai e ka fituar pesë herë çmimin prestigjioz individual "Topi i Artë", gjë të cilën deri tash e ka bërë vetëm rivali i tij i përhershëm, Cristiano Ronaldo.

Karriera e Messit, i cili i ka mbushur 31 vjet në muajin qershor, nuk ka përfunduar ende. Madje argjentinasi në këtë fillim të sezonit ishte i shkëlqyeshëm, duke realizuar 11 gola në 10 ndeshje në mes La Ligas dhe Championsit. Numra të një fenomenit. Numra që mund t'i bëjë vetëm Messi. Prandaj edhe Barcelona e feston çdo vit 16 tetorin.



## Në Itali e shohin Modricin tek Interi falë Hazardit

Fjalët e dashurisë së Hazard ndaj Real Madridit duket se kanë vënë në punë drejtuesit e Chelsea. Sipas "La Gazzetta dello Sport", ekipi londinez ka vënë në tryezë rritjen e pagës së ndërkombëtarit belg në 18 milionë euro neto në sezon dhe një zgjatje të kontratës, që përfundon në vitin 2020. Një shifër që nuk dihet nëse do të pranohet nga Hazard, gjithmonë sipas medias së njohur italiane. "Nëse ndonjëherë mund të luajë për Real Madridin, do të isha shumë i lumtur. Edhe në qoftë se kurrë nuk do të luaj për Real Madridin, asgjë nuk ndryshon. Gjithmonë do të jem i lumtur te Chelsea", deklaroi Hazard kohët e fundit, i cili ka marrë një ofertë nga "Los Blancos" verën e kaluar, por klubi anglez e kundërshtoi atë plotësisht. Përveç kësaj, La Gazzetta tregon se Interi mbetet shumë i vetëdijshëm për këtë operacion, teksa vazhdon përpjekjet për të siguruar shërbimet e Luka Modric, të cilit, gjithashtu, i përfundon kontrata në vitin 2020. Lojtari kroat ishte afër zikaltërve kësaj vere, por Real Madridi nuk lejoi largimin e tij. Verën e ardhshme ai do të kthehet në krye të listës së dëshirave të Interit, edhe për faktin se kroatit i mbetet vetëm një vit kontratë në "Santiago Bernabeu". Real Madridi i ka ofruar 10 milionë euro në sezon kandidatin të madh për të fituar "Topin e Artë" këtë vit, në mënyrë që ta zgjasë angazhimin në kryeqytetin spanjoll. Në rast se Hazard përfundon te Real Madridi, atëherë zikaltrit do ta shihnin më të realizueshme ëndrrën e tyre për të marrë shërbimet e Modric, i cili mbushi 33 vjeç kohët e fundit.



## Dëmtohet Dybala

Sulmuesi i Juventus Paulo Dybala do të vlerësohet në ditët e ardhshme, pasi ka pësuar një dëmtim me Argjentinën. La Joya luajti ndaj Brazilit mbrëmjen e së martës, me Joao Miranda-n e Inter që shënoi golin e vetëm të ndeshjes për Selecaon. Dybala ka dalë nga loja në minutën e 57-të, dhe është parë duke vendosur akull në gjurin e tij. Sipas Fox Sports, përshtypja e parë është se nuk duket një dëmtim serioz, por sulmuesi gjithsesi do të vlerësohet kur të kthehet në Torino. Juve do të ndeshet me Genoa në fundjavë, por është e mundur që Dybala të pushojë atë ndeshje për të qenë gati për Manchester United në Champions League.

## Neymar zbulon se si ishte i detyruar të merrte numrin 10 te Brazili

Neymar Jr. ka treguar historinë se si e kishte veshur fanellën e Brazilit me numrin 10, edhe pse preferencat e tij ishin të ndryshme. As preferenca e tij e parë, as e dyta nuk ishte numri 10 i Pele, por "7" dhe "11". "Robinho ishte gjithmonë idhulli im më i madh. Te Santos, pra, kam kërkuar për të luajtur me numrin 7 dhe fillova duke e përdorur atë. Pastaj, erdhi përsëri Robinho dhe unë doja ta respektoja atë. Kështu, unë mora numrin 11, i cili ishte opsioni i dytë, që mua më pëlqente", pohoi Neymar në një deklaratë të bërë për "UOL Esporte". Me Brazilin, Neymar ka veshur fanellën me numër 11, por erdhi një moment, që çdo gjë ndryshoi.



"Në Kupën e Konfederatave të mëparshme, Dani Alves i tha Scolarit se i pëlqente "7" dhe "11". Alves më shikoi mua dhe më tha: "Ti je për "10", merre dhe mbaje këtë fanellë. Duhet ta veshësh". Gjatë kar-

rierës së tij në nivel klubi, në mes viteve 2013 dhe 2017, nga prania e Leo Messit, Neymar iu kthye numrit 11, por kur u transferua te PSG për shumën rekord të 222 milionë eurove, i ishte rezervuar "10".

## Rikthehen gratë në futbollin iranian

Rreth 100 gra ishin të pranishme në stadiumin në Teheran për ta shikuar një ndeshje miqësore mes Iranit dhe Bolivisë. Kjo po shihet nga shumë persona si hap i qartë në drejtimin e duhur në luftë për të drejtat e grave në këtë vend. Për 37 vite të plota, asnjë grua nuk lejohet të futej në stadium, pasi qeveria islamike e kishte marrë pushtetin dhe i ua kishte ndaluar atyre përcjelljen e ndeshjeve në stadione në fund të viteve 1970-ta.

Hera e fundit që gratë ishin lejuar në stadione të futbollit në Iran ishte në vitin 1981, dhe pas këtij viti ato detyroheshin të maskoheshin si burra—duke rrezikuar të arrestoheshin—në mënyrë që të shikonin futboll nga tribunat në vendin e tyre. Sipas agjencisë shtetërore e lajmeve ILNA, vetëm një grup i përbërë nga familjaret e lojtarëve e patën privilegjin ta shikonin ndeshjen ndaj Bolivisë nga afër. Ato patën rastin ta shihnin Ira-



nin duke e mposhtur Bolivinë 2-1 falë golave të Alireza Jahankaksh dhe Mehdi Torabi. Ato u panë në tribuna dhe e thyen barrierën e

madhe që ka shkaktuar ankesa të panumërta nga shoqatat, aktivistët dhe qeveritë për shkelje të drejtave të grave.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Në dashuri po afrohet një fat i madh, i cili favorizohet nga një qiell i cili favorizon lidhjet e lindura së fundmi. Do të jeni më të sigurtë në veten tuaj dhe vendosmëria që do të shfaqni do lejojë që të keni sukses në një intervistë pune.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Mundohuni që të shikoni përreth pasi parashikohen mundësi të mira për të bërë njohje të reja. Kjo e mërkurë do ju shohë mjaft të zënë në realizimin e një projekti të ri krijues. Këshillohet që në familje, të mos tregoheni shumë të largët.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Kjo e mërkurë do të jetë disi e turbullt për shkak të disa keqkuptimeve që keni patur në punë ose me partnerin/en. Do të jeni të lodhur dhe të acaruar dhe ky humor i keq mund të prish një raport tuajin.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Parashikohet një qiell interesant për takimet, qoftë të natyrës sentimentale dhe profesionale. Intuita e mirë do ju lejojë që të ndryshoni interesat siç ju leverdis më shumë. Në familje, këshillohet që të jeni më të kuptueshëm.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Do të jeni në kërkim të stimujve të rinj ku të kapeni, sidomos tashmë që ndiheni të kënaqur nga lidhja juaj apo nga puna. Parashikohet një mbrëmje mjaft relaksuese dhe plot shkëndija në dashuri.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Ka disa keqkuptime të cilat duhet ti mbani nën kontroll. Duhet të jeni të gatshëm që në fushën e ndjenjave të bëni një hap përpara, sidomos nëse së fundmi keni përjetuar zhgënjime.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Shmangni tepritë, sidomos nga pikëpamja e sforcimeve fizike. Jeni përfshirë në angazhime shumë të lodhshme të cilat mund të çekuilibrojnë ditën tuaj. Në dashuri, regjistrohen momente interesante, por duhet të jeni të gatshëm që të kënaqni edhe disa nevoja të partnerit/es tuaj.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Ky është momenti më i mirë për të menduar më shumë për veten dhe pretendimet tuaja. Dashuria do të marrë vëmendjen tuaj kryesore dhe rigjetja e harmonisë në çift do ju lejojë që të vlerësoni më mirë kapacitetin tuaj.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Duhet të punoni fuqishëm për të arritur një objektiv të rëndësishëm. Mundohuni të jeni më të sigurtë në vete dhe fokusohuni në prioritetet që keni. Nisja e një historie të re dashurie, mund të çojë në ndërmarrjen e një rrugëtimi interesant.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Në dashuri parashikohen mundësi të mira, sidomos nëse jeni në kërkim të një stabiliteti që të zgjasë. Duhet të guxonit dhe të hidhni hapin e parë, pasi nuk përjashtohen zhvillimet interesante. Vlerësoni më shumë kohën e kaluar bashkë, në mënyrë që të arrini të planifikoni arratisje romantike dhe aktivitete të reja në çift.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt


Këshillohet që të ndiqni instinktin tuaj. Para jush hapet një qiell mjaft i favorshëm i cili do ju mbushë me kurajo dhe forcë. Çuarja përpara e ideve të reja, do ju mundësojë realizimin e projekteve të mëdha.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Do të jeni shumë të tensionuar gjatë kësaj dite, ndoshta për shkak të ndonjë tensioni ose keqkuptimeve me familjen ose partnerin/en. Puna po ecën më së miri dhe marrëveshjet e reja do të jenë mjaft të favorshme.

Mensur Mamuti	KËNGË E KËNGËTARIT NË FOTO	MODELE BOSHNIAKE	DAULLE	LLOJ PUSHKËSH TE USHTRISE JAPONEZE	SHTET NË SHBA
AITHERRËS KOKASH					
AUTORI FRËNG, DE BALZAK					
KËNGË E KËNGËTARIT NË FOTO					
IKACAKE					
BARABAR, NJESOU					
KARTELA E IDENTIFIKIMIT			KËRÇOVA SHTET NË AZI		
BALTA E QULLËT, GJANA (KRAHIN.) HEJBE					LYEJ DIÇKA ME AR, E BËJ TE SHKËLQEJË
<b>D</b>				FOSFORI ÇAJ TURK FRUTASH (SH.)	
GJERMANIA		VRIMË E IMËT NË LËKURË KËTË DITË			KËNGËTARI I FAMSHËM AMERIKAN NË FOTO
<b>KOHA</b>	KOMPOZITORI SHKODRAN, SHPETIM AUTORI YNË, ISMAIL				ISMET DEMAJ PËRMIRËSIM I MARRËDHËNIEVE TE PALEVE TE HIDHËRUAR ADNAN JANUZAJ VAJ (ANG.)
SHTET NË SHBA (SHQ.)					
ASTATI			FILOZOFI ANGLEZ, XHON SHOQE MIKESHË		FILM I SPILBERGUT (E.T.) KËNGËTARI ITALIAN, RAMAXOTI
500 ROMAK		HIT I KËNGËTARIT NË FOTO SASI SHUMË E VOGEL PEMESH			
AFROJ (BISED.)				ERBIUMI NUMRI	NOTË MUZIKORE LABINOT TAHIRI
ZHANRI I MUZIKËS SË KËNGË NË FOTO AUTORËT E LETËRSISË SË BUKUR					SUEDIA Ë
<b>B</b>					



ZGJIDHJET: XHELAT ONORE, NADIN, IKËSE, BARAS, ID, KI, GINA, DUQE, P, D, POR, P, SARACI, AJ, KOLORADOJA, AT, LOK, ITI, D, MEJBELIN, AVIT, ER, MI, ROK EN ROL, S, BELETRISTËT.


Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

				5		9	7	8			8			4	9		
					8		1	4		1	9				4	2	
					6		2			7		9				1	
	7	4		1					7	6			3			9	4
6				5		2		9					1		2		
					8		7	3					4				
	3			4						2		8					6
8	4			9						8	7					1	5
2	1	9		3							6				5	7	

Shumë i lehtë: 462153978, 357298614, 198746523, 574319286, 683572149, 921684735, 735461892, 846927351, 219835467. Mesatar: 638214975, 519687423, 274953816, 761538294, 943162587, 852749631, 425871369, 387496152, 196325748.



## Karrige me rrota edhe për breshkat e dëmtuara



Ekipi veterinar i kopshtit zoologjik të Maryland-it në Baltimore, SHBA, ndërtoi një karrige me rrota me tulla për të ndihmuar një breshkë që i ishte thyer zhgualli. Dr. Ellen Bronson, shpjegoi se kafsha "kishte thyerje të shumëfishta, u ballafaquam me një sfidë të vështirë, duke ruajtur lëvizjen e breshkës, duke e lejuar atë të shërohet". Veterinarja Garrett Fraess, një studente e vitit të katërt, arriti me idenë e karriges me rrota. "Zakonisht nuk bëhen karrige me rrota që të përshtaten me madhësinë e një breshke, kështu që kam hartuar disa skica për një karrocë të personalizuar dhe pastaj i dërgova te një mik".



## Ra nga shtrati gjatë marrëdhënies me partnerin dhe u paralizua...

Një grua që mbeti e paralizuar pasi u "katapultua" nga shtrati i saj i ri gjatë kohës që po kryente marrëdhënie seksuale me partnerin e saj, kërkon dëmshpërblim nga kompania e krevateve. Claire Busby nga Maidenhead në Berkshire të Britanisë pësoi dëmtim kurriore pasi ra nga shtrati i saj 'super king-size'. 46-vjeçarja tha se po nis një betejë ligjore kundër "Berkshire Bed Company", me pretendimin se i kishin shitur një shtrat defektoz. Busby u dëmtua vetëm një javë pasi kishte blerë krevatin e ri, teksa po kryente marrëdhënie me partnerin e saj John Marshall. Ajo pretendon se bazamenti i krevatit, i ndarë në dy pjesë që ngrihen, nuk ishin lidhur siç duhet me njëra-tjetrën dhe se krevatit i mungonin dy këmbë në fund. Por, avokatët e kompanisë argumentuan se krevati ishte montuar siç duhet, dhe edhe nëse dy këmbët e krevatit mungonin kjo nuk do të shkaktonte "katapultimin" e gruas. Nëna e 4 fëmijëve kërkon 1 milionë paund dëmshpërblim, ndërsa vendimi do të merret në Gjykatën e Lartë.



## Burri gënjeu se kishte kancer, gruaja: Më vodhi vite nga jeta ime



Një grua, burri i të cilës pretendonte se kishte kancer, thotë se vitet e tij duke gënjyer i vodhën një pjesë të madhe të jetës. Lucy Witchard nga Leicester, tha se David Carroll, 35 vjeç, i tha asaj se kishte leuçemi kur u takuan në vitin 2006. Pavarësisht kësaj, ata u martuan në 2011. Në vitin 2015, nëna e saj i dha 2 mijë dollarë për trajtim në SHBA pasi ai tha se

kanceri ishte në fazën e fundit. Carroll u dënua me burg për mashtrim në Gjykatën e Magjistraturës në Leicester javën e kaluar. Gjatë katër viteve të martesës, Carroll kishte gënjyer edhe për kancerin e prostatës e stomakun, por më vonë e pranoi këtë. E vërteta u zbulua kur familja filloi dyshimet kur ai po shijonte pushimet në vend që të bënte trajtimet.

## 70-vjeçarja thyen rekordin botëror në maratonë

Një pensioniste ka thyer rekord botëror në Maratonën e Bostonit. Jeannie Rice mbaroi garën për rreth 3 orë e gjysmë. 70-vjeçarja vendosi rekord për kategorinë e moshës së saj dhe mbylli konkurrimin për 3 orë 27 minuta dhe 50 sekonda. Gjyshja nga Ohio pasi kaloi vijën e finishit tha se ndihej absolutisht shumë mirë. Rekordi i mëparshëm për kategorinë e femrave 70+ ishte 3 orë, 35 minuta dhe 29 sekonda i vendosur nga nga Helga Miketta në vitin 2013 Jeannie e theu rekordin me më shumë se shtatë minuta. Ajo ka marrë pjesë në maratona gjatë gjithë jetën e saj, me debutimin e parë më 1984 në Cleveland. Koha e saj më e shpejtë e regjistruar ishte tre orë dhe 16 minuta në Columbus. Ndërsa në Çikago ishte maratona e saj e 116-të. "Kam vrapuar për më shumë se 35 vite dhe kjo është pjesa më e rëndësishme e jetës sime", tha ajo. "E dua konkurrimin dhe përgatitja për garë më mban të motivuar për të vrapuar më shpejt dhe më mirë".



802 - Dëbohet Perandresha Irena e Bizantit

1517 - Lutheri jep 95 teza në Kishën Wittenberg - Reformacioni protestant

1541 - Michelangelo Buonarroti përfundon pikturën e tij "Dita e Gjykimit" në Kishën e 16

1888 - John Boyd Dunlop patenton gommat pneumatike të biçikletës.

1892 - Arthur Conan Doyle boton veprën "Aventurat e Sherlock Holmes"

1905 - Demonstratat e mëdha revolucionare për amnisti në Sent Petersburg

1914 - Britania e Madhe dhe Franca i shpallin luftë Turqisë

1920 - Romania përvetëson Besarabinë.

1922 - Benito Mussolini (Il Duce) bëhet kryeministër i Italisë

1932 - Bie qeveria e Venizelos në Greqi

1941 - Përfundojnë punimet në Mount Rushmore

1956 - Britania dhe Franca fillojnë të bombardojnë Egjiptin për të rihapur Kanalin e Suezit.

Pesë herë fituesi i Tour de France, 19-vjeçari Migeel Indurain, kishte 28 rrahje zemre në minutë kur pushonte. Një njeri i zakonshëm, ka një normë prej 60 rrahjesh në minutë, kur nuk është duke kryer ndonjë aktivitet fizik.



Kërpudhat mund të krijojnë një flad të lehtë, edhe kur ajri është i qetë. Ato lëshojnë avuj uji, duke e ftohur ajrin, dhe krijuar kështu një rrymë konveksioni që ndërpret ajrin duke lëvizur, duke zhvendosur sporet e veta.



### MUSHKONJAT ME ELEKTRIKË

Fëmija : O babi, më pickojnë mushkonjat!

Babi: Fike dritën se nuk të pickojnë më!

Pas 10 minutash hynë disa xixëllonja.

Fëmija bërtet : Oooo Babi!

Babi: Po tani çfarë ke?!

Fëmija: Tani erdhën me elektrik!



Belaja më e madhe është të qeshësh me hallin që të ka rënë!  
(Charles Bukowski)



KALENDARI HISTORIK 18 TETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS